KUMTESAT E SIMPOZIUMIT "MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE"
9 MAJ 2018

SPEECHES AT SYMPOSIUM "ALBANIAN-TURKISH RELATIONS"
9 MAY 2018

"ARNAVUT-TÜRK İLİŞKİLERİ" SEMPOZYUM BİLDİRİLERİ
9 MAYIS 2018

Botimi i dytë / Second edition / İkinci baskı

TIRANË / TIRANA / TIRAN
2019

Titulli / Title / Eserin Adı
KUMTESAT E SIMPOZIUMIT "MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE"
SPEECHES AT SYMPOSIUM "ALBANIAN-TURKISH RELATIONS"
"ARNAVUT-TÜRK İLİŞKİLERİ" SEMPOZYUM BİLDİRİLERİ

Përgatiti për botim / Prepared for publication / Yayına hazırlayan:
Mehdi Gurra

Përkthimi / Translation / Tercüme:
Anglisht: Ergys Bezhani
Turqisht: Furkan Abdula

Redaktimi / Editing / Editör
Shqip: Petrit Bezhani
Anglisht: Viola Jonuzi
Turqisht: Ruhi Can Alkın

Faqosja & Kopertina
Halil Berisha

BORDI BOTUES-ALSAR
Mehdi Gurra-Kryetar bordi
Sajmir Rusheku-Teolog
Prof. Dr. Zyhdi Dervishi-Sociolog
Prof. Dr. Luan Malltezi-Historian
Dr. Abaz Hado-"Mjeshtër i Madh"
Shaban Murati-"Mjeshtër i Madh"
Sherif Delvina-Historian

Botimi i dytë / Second edition / İkinci baskı

ISBN: 978-9928-243-53-9

Tiranë, 2019

Adresa: Rruga e Bogdanëve, P. Eurocol, Kati 1.
Tiranë-Albania
Tel: 00355 4 2241 852
e-mail: fondacionialsar@gmail.com
e-mail: alsarvakfi@gmail.com
e-mail: alsarfoundation@gmail.com
web: www.alsar.al

KUMTESAT E SIMPOZIUMIT

Marrëdhëniet shqiptaro - turke

9 MAJ 2018

SPEECHES AT SYMPOSIUM

Albanian - Turkish relations

9 MAY 2018

Arnavut-Türk ilişkileri

SEMPOZYUM BİLDİRİLERİ

9 MAYIS 2018

TIRANË / TIRANA / TIRAN
2019

PËRMBAJTJA | CONTENTS | İÇİNDEKİLER

6 | PARATHËNIE
12 | FOREWORD
18 | ÖNSÖZ

Mehdi Gurra
29 | FJALA E HAPJES
35 | OPENING SPEECH
41 | AÇILIŞ KONUŞMASI

Suzana Jahollari
46 | FJALË PËRSHËNDETËSE
48 | GREETING ADDRESS
50 | SELAMLAMA KONUŞMALARI

Murat Ahmet Yoruk
52 | FJALË PËRSHËNDETËSE
56 | GREETING SPEECH
60 | TÜRKİYE CUMHURİYETİ TİRAN BÜYÜKELÇİSİNİN SELAMLAMA KONUŞMASI

Bülent AKYAY
64 | "MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE NË PERİUDHËN E VITEVE (1923-1938).
86 | "ALBANIAN-TURKISH RELATIONS DURING THE PERIOD 1923-1938
107| TÜRKİYE-ARNAVUTLUK İLİŞKİLERİ (1923-1938)

Ferit Duka
128 | TURQIA DHE ATATURKU NË SHTYPIN SHQIPTAR TË VITEVE 20-30 TË SHEK. XX
133 | TURKEY AND ATATÜRK IN THE ALBANIAN PRESS DURING THE 1920S-30S
138 | YÜZYILIN 20-30'LU YILLARINDA ARNAVUTLUK BASININDA TÜRKİYE VE ATATÜRK

Çınar Özen

143 | "SHQIPËRIA NË POLITIKËN BALLKANIKE TË TURQISË; NJË VLERËSIM HISTORIK".

149 | "ALBANIA IN THE BALKAN POLITICS OF TURKEY: A HISTORICAL EVALUATION"

154 | "TÜRKİYENİN BALKAN POLİTİKASINDA ARNAVUTLUK"

Shaban Murati

160 | KONTEKSTI RAJONAL I ALEANCËS STRATEGJIKE SHQIPËRI-TURQI

166 | REGIONAL CONTEXT OF THE STRATEGIC ALBANIA-TURKEY ALLIANCE

172 | ARNAVUTLUK-TÜRKİYE STRATEJİK İTTİFAKININ BÖLGESEL BAĞLAMI

Halil Hyseni

178 | REALITETE TË MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE SHQIPTARO – TURKE PËRMES ARKIVËS SË MINISTRISË SONË TË PUNËVE TË JASHTME.

184 | REALITY OF ALBANIA-TURKEY DIPLOMATIC RELATIONS IN OUR FOREIGN AFFAIRS MINISTRY ARCHIVE

190 | ARNAVUTLUK DIŞİŞLERİ BAKANLIĞI ARŞİVLERİNE GÖRE ARNAVUTLUK-TÜRKİYE DİPLOMATİK İLİŞKİLERİNİN GERÇEKLERİ

Klevis Kolasi

196 | PROBLEMET ME TË CILAT U PËRBALL SHQIPËRIA QË NGA VITET 1990 DHE ROLI I TURQISË

203 | THE PROBLEMS ALBANIA HAS FACED SINCE 1990 AND TURKEY'S ROLE

209 | 1990'LARDAN GÜNÜMÜZE ARNAVUTLUK'UN KARŞILAŞTIĞI SORUNLAR VE TÜRKİYE'NİN ROLÜ

216 | SIMPOZIUM SHKENCOR "MARRËDHËNIET VËLLAZËRORE DHE STRATEGJIKE SHQIPTARO-TURKE".

220 | THE SCIENTIFIC SYMPOSIUM: "FRATERNAL AND STRATEGIC ALBANIAN-TURKISH RELATIONS"

224 | "ARNAVUTLAR VE TÜRKLER ARASINDA KARDEŞLİK VE STRATEJİK İLİŞKİLER" KONULU BİLİMSEL SEMPOZYUM

PARATHËNIE

Të flasësh apo të shkruash për marrëdhëniet shqiptaro-turke është sa e lehtë, aq edhe e vështirë. Gjithmonë të pranishme, këto marrëdhënie kanë patur sigurisht lëkundjet e tyre në kohë, në varësi të zhvillimeve brenda dhe jashtë territoreve të këtyre dy vendeve.

Pavarësisht nëse në periudha të ndryshme ato janë zbehur apo janë dendësuar, çfarë nuk ka ndryshuar asnjëherë ka qenë qasja e ndërsjelltë miqësore, të vështruarit e njëri-tjetrit si mbështetje.

Bërja e një analize të gjerë të këtyre marrëdhënieve na shërbeu si shtysë për t'i hyrë organizimit të një konferencë shkencore, me to si temë qendrore. Diplomatë e historianë do të kishin mundësi të flisnin në konferencë për marrëdhëniet shqiptaro-turke, dhe kush më shumë e kush më pak do ta vinin në pah nevojën për forcimin më tej të tyre. Një ndihmë me këtë rast na dha ambasadori i Republikës së Turqisë, z. Murat Ahmet Yörük, i cili na sugjeroi emrat e personaliteteve turke që mund të ftoheshin për të folur në këtë aktivitet. E falënderojmë përzemërisht për bashkëpunimin në përzgjedhjen e këtyre personaliteteve. Dhe njëri prej këtyre të fundit, z. Çinar Özen, duhet falënderuar po ashtu për gatishmërinë për ndihmë. Qe sugjerimi i tij që solli në konferencë si folës një prej shqiptarëve që jetojnë e punojnë në Turqi, z. Klevis Kolasi, mësimdhënës atje.

Kontekstet historike janë mjaft të rëndësishme nëse do duam të flasim objektivisht mbi këto marrëdhënie, por nuk duhen lënë në harresë kurrsesi kontekstet kulturore. Fakti se jemi dy popuj që kemi ecur bashkë në histori si pjesë e perandorisë më të madhe të kohës është thelbësor për një analizë realiste, të pacenuar nga lloj-lloj fantazmash. Pikëtakimet e shumta kulturore, mënyra të ngjashme të të jetuarit, të të vepruarit, të të menduarit, janë po ashtu në favor të një marrëdhënieje miqësore, ndoshta dhe më tepër se kaq.

E shkuara e përbashkët pesëqindvjeçare në Perandorinë Osmane bëhet herë-herë një pengesë artificiale për marrëdhëniet miqësore.

Kjo pengesë shfaqet sa herë që gjallërohen mosdashësit e brendshëm dhe të jashtëm të kësaj miqësie. Hyjmë në lëmin e historianit kur kërkojmë të flasim e të japim përfundime për atë bashkëjetesë të gjatë për shekuj me radhë. Historiani serioz e objektiv e ka për detyrë të japë pa paragjykime e tendenciozitet një përcaktim adekuat, të pandikuar nga historiografia e dekadave komuniste. Vlen të nënvizohet megjithatë se Perandoria Osmane ishte edhe një perandori e shqiptarëve. Këtë e mbështet një shifër domethënëse: ishin 33 prej shqiptarëve që shërbyen si kryeministra, veç shumë të tjerëve me poste të larta. Në çdo rast, njësimi i Republikës së Turqisë me atë perandori në mos qoftë i qëllimshëm, është mendësi e krijimit të armikut pa e patur atë.

Nga këndvështrimi i zhvillimeve të sotme, teksa bota po përballet me paqartësi mbi të ardhmen, me kriza ekonomike, me fuqizime të ca fuqive globale, e dobësime të ca të tjerave, me zhvendosje të boshteve të fuqisë, në atmosferën e një tjetër lufte të ftohtë, me një Bashkim Europian jo të konsoliduar si dhjetë apo njëzet vite të shkuara, që po humbet dhe Britaninë prej Brexit-it, në një Ballkan ku paqja dhe lufta gdhihen e ngrysen bashkë, marrëdhëniet sa më të ngushta miqësore shqiptaro-turke janë tejet të nevojshme të zhvillohen në kuadër të një partneriteti strategjik.

Nuk duhet të kemi dilema për rrugën tonë, të drejtuar për nga BE-ja, sepse, në këtë aspekt, as Turqia, meqë e kemi atë në analizë, nuk po na kërkon diçka tjetër. Për më tepër, ajo vetë e kërkon anëtarësinë në këtë bashkësi europiane. I përkasim Europës, e askush nuk pretendon të kundërtën, as po mëton të na imponojë Lindjen si përkatësi. Përndryshe, një marrëdhënie e tillë e forcuar na afron më shumë me një fuqi rajonale dhe me shtetin më të fuqishëm ballkanik, me një zë të fortë edhe global, na jep mundësi të thithim investime ekonomike që na mungojnë nga anë të tjera, na jep më shumë siguri, na mundëson të kemi një përkrahës të fuqishëm, të vlefshëm dhe të nevojshëm për çdo gjë.

Forcimi një marrëdhënie sa më të ngrohtë dhe më të ngushtë mes dy vendeve është shqetësim i vazhdueshëm i shumë segmenteve të shoqërisë sonë. Përpjekjet nuk mungojnë në këtë drejtim, siç ka dhe orvatje sporadike për të vënë shkopinj në rrota.

Marrëdhëniet kanë dy anë, dy palë, dhe reflektimi duhet të jetë në këtë mënyrë në sintoni. Pasja e një qielli pa re në këto marrëdhënie kërkon qartësi reciproke, hapa të kujdesshëm, punë efektive, kërkon kuptim të situatës dhe mirëkuptim për të.

Baza për këtë është njohja e realiteteve. Turqia, më së pari, ka një problem që lidhet me dallimin ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Po qe se thua "shqiptar" në Turqi, konceptimi është i njëjtë, pa një ndarje të tillë. Këtu ndodh një keqkuptim, një gabim, se shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë kanë një tjetër brymosje, janë rritur në tjetër klimë, ngaqë nuk e kanë përjetuar ndalimin e fesë, si këtu tek ne, janë udhëzuar përmes fetvave të ulemasë për mbajtjen e lidhjeve të forta me turqit, si një popullsi muslimane, janë këshilluar për martesa me ta. Besimi i përbashkët i ka mbajtur lidhur, ndryshe nga sa ngjau me shqiptarët këtej kufirit, që provuan imponimin e ateizmit, e kështu panë hendekun të hapej para tyre.

Duhet kuptuar se Turqinë e shohin shumë më të afërt në pjesën përtej të kufirit, në dy vendet e përmendura më sipër. Marrëdhënia e pandërprerë fizike për asnjë çast, zhvendosjet e një numri të madh njerëzish nga Kosova dhe Maqedonia për të jetuar në Turqi prej vitesh e dekadash, shkëmbimet njerëzore, martesat, pakicat etnike turke në to, një mënyrë thuajse e njëjtë të jetuari, një prani tradicionale e turqishtfoljes, i bëjnë vërtet vëllezër shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë. Prandaj dhe përdorimi i togfjalëshit "marrëdhënie vëllazërore", apo i emërtimit "vëllezër" për ta, është fare me vend.

Shqiptarët e Shqipërisë i përkasin një realiteti tjetër, janë në këndvështrimin e këtyre marrëdhënieve një entitet thuajse më vete. Vërtet, marrëdhënie të mira me Turqinë u ruajtën edhe gjatë regjimit të Enver Hoxhës. Vetë ky u kujdes posaçërisht për përzgjedhjen e njerëzve që e përfaqësonin vendin tonë në Turqi. Vajtja dhe ardhja e grupeve artistike në vitet '80 të shekullit të shkuar ishte, për shembull, e zakonshme. Marrëdhënia ishte sidoqoftë më zyrtare, më protokollare. Më tej, në fillim të viteve '90, vendi përballej me mungesa të jashtëzakonshme dhe ishte në prag të rrënimit. Një operacion ndërkombëtar do të niste për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve. Mielli do të vinte nga Turqia, ushqimet nga Europa, shpërndarë nëpërmjet operacionit "Pelikan", por kontributi turk do të kalohej në heshtje. Nga këtej mori udhë ndarja. Në vite

marrëdhënia do të përballej me kundërvënie, konotacioni i së cilës ishte dhe është i ndërthurur, antiturk dhe antiislam. Kundërvënie që do të jepte efekt, duke na sjellë në mendje fjalët e shejhulislamit të fundit osman, Mustafa Sabri Efendiut: "Drejtësia e paorganizuar humbet karshi padrejtësisë së organizuar."

Kësisoj, ka një dallim mes shqiptarëve në dy anët e kufirit, që nevojitet të merret në konsideratë. Cilësimi i marrëdhënieve shqiptaro-turke si "miqësore" do të shmangte çdo ngacmim nervi, çdo përpjekje për polemikë; me një fjalë, do t'i linte pa kauzë të prirurit për një marrëdhënie shumë më të ftohtë, mbase dhe për mungesën e plotë të saj. Për më tepër, do t'i bënte dhe miqtë tanë turq të vetëdijshëm për një mënyrë më të përkorë sjelljeje në vendin tonë.

Nevojitet një analizim, një vështrim më i thellë i çështjeve të Shqipërisë dhe shqiptarëve, për të shmangur çdo paqartësi në gjykim, çdo ngatërresë që nuk do t'i bënte mirë as njërës e as tjetrës palë.

Kolegjet turke gjetën terren të lirë në Shqipërinë postkomuniste dhe filluan të vinin bazat pas vitit 1992. Ato u panë si përfaqësuese të shtetit turk, dhe vetë po ashtu qenë të interesuara të perceptoheshin në atë mënyrë. Në mjedisin tonë mbizotëronte mendimi se më mirë t'i hapej rruga muslimanit, se grekut. Dhe kur shteti turk u hapi luftë këtyre kolegjeve, një rrjeti të tërë shkollash, ku nxënësit indoktrinoheshin prej një organizate me petk fetar, organizuese të një përpjekjeje të përgjakshme për grusht shteti në Turqi më shumë se dy vite më parë, shumë e patën të vështirë të bëjnë një vlerësim të saktë. Bashkëshoqërimi i këtyre kolegjeve me shtetin turk duhet pranuar se ka qenë i dëmshëm. Një rinovim imazhi është i nevojshëm; kërkohet angazhim në media, botime, veprimtari akademike.

Me tepër rëndësi është përcjellja saktësisht te autoritetet turke e realitetit shqiptar. Një panoramë e mangët ose e zbukuruar sjell dëm dhe nuk i shërben forcimit të marrëdhënieve të çdo rangu qofshin. Çdo vlerësim i cunguar lë gjurmën e vet, prandaj është i domosdoshëm serioziteti në paraqitjen e fakteve. Ka sigurisht vend për përmirësim, për reflektim.

Të paktë, të rrallë, kanë qenë zërat mediatikë që janë përpjekur t'i pasqyrojnë siç duhet marrëdhëniet shqiptaro-turke, që janë orvatur të shpjegojnë qasjen qëllimmirë të Turqisë, apo të thonë se asnjë e keqe nuk rrezikon të na vijë prej tyre. Fryma tendencioze e mediave

në përgjithësi mbetet po ajo, edhe për arsye të nivelit të tyre shpesh nën atë mediokër.

Kompani të shumta turke gjenden në Shqipëri dhe kontribuojnë për t'i dhënë më hov ekonomisë së vendit. Turq të shumtë jetojnë e punojnë këtu, synimet në shifra premtojnë për të tjerë njerëz e kompani që do të vijnë nga ky vend mik. Mes institucioneve turke në vendin tonë, për punën jashtëzakonisht të mirë mund të përmendet pa mëdyshje TİKA, Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim. TİKA ka një aktivitet të dendur, duke kontribuar në shumë fusha, dhe është sot model për bashkëpunimin dypalësh.

Por për një arsye apo për një tjetër, me gjithë praninë në mjedisin shqiptar, sponsorizimet e shumta dhe aktivitetet e zhvilluara prej tyre, mungon çuditërisht ushtrimi i një ndikimi të fortë për ndryshimin e një mentaliteti të zënë rrënjë.

Në këto kushte kërkohet sjellja e një alternative të re, nëpërmjet Fondacionit Maarif dhe Diyanet-it, dy instrumente të fuqishme të shtetit turk. Puna ka nisur, megjithëse jo me ritmin e dëshiruar. Shumë mbetet për t'u bërë!

Detyrë mjaft delikate ka, për shembull, Fondacioni Maarif, në hapat e parë të vendosjes në një mjedis ku më herët ka vepruar organizata famëkeqe gyleniste. Fondacioni ka blerë një zinxhir shkollash që akoma është e vështirë të shihen si turke, qoftë për shkak të emrit të pandryshuar, të programit mësimor apo të personelit mësimdhënës gjithashtu të paprekur nga ndryshime të qenësishme. Nga jashtë, me syrin e një të painformuari, është e pamundur të kuptohet se ky zinxhir shkollash i përket Fondacionit Maarif!

Apo, për të shkuar më tutje, të flasim për Komunitetin Musliman të Shqipërisë, institucionin përfaqësues të muslimanëve të vendit tonë. I rënë në dorë të së njëjtës organizatë famëkeqe, ai vazhdon të mbetet zbatues i politikave të saj. Drejtuesit, me legjitimitet të humbur, bëjnë karshillëk nga godina e Komunitetit, ndërkohë që përpjekjet e besimtarëve muslimanë për largimin e tyre kanë qenë të pamjaftueshme, të vagullta, pa rezultat konkret. Ditën që këta drejtues do të jenë të detyruar t'i lënë zyrat e KMSH-së, kujdes i veçantë duhet bërë për emërimet e reja, për të cilat duhet të ketë një konsensus sa më të gjerë.

Marrëdhëniet shqiptaro-turke mund të njohin përmirësim të mëtejshëm dhe çuarje përpara nëse personeli turk i sjellë këtu është i njohur me historinë e tyre, nëse ky personel është i pjekur, me përvojë. Kërkohet më tepër efikasitet, shmangie e pështjellimit, njëzëshmëri në veprim, largpamësi.

Në nivel institucional, me ardhjen në pushtet të Edi Ramës, pati një shpallje të partneritetit strategjik me Turqinë, diçka e pranuar nga të dyja palët, por ende e pazyrtarizuar. Miratimi me votim në parlament është i domosdoshëm për të plotësuar kuadrin ligjor të një marrëveshjeje bashkëpunimi të nivelit të tillë. Një firmosje e marrëveshjes së partneritetit strategjik nga krerët shtetërorë pritet të bëhet gjatë një vizite të mundshme të presidentit turk, Recep Tayyip Erdoğan, në Tiranë. Ardhja e ministrit të Jashtëm turk, Mevlüt Çavuşoğlu, në mesin e muajit tetor të këtij viti në kryeqytetin e Shqipërisë, u shoqërua me firmosjen me homologun e tij, Ditmir Bushati, të deklaratës së përbashkët politike për themelimin e Këshillit të Nivelit të Lartë të Bashkëpunimit Turqi-Shqipëri. Iniciimi i dokumentit të partneritetit strategjik për themelimin e këtij këshilli u paraprin gjithashtu takimeve periodike dhe mbledhjeve të përbashkëta të dy qeverive.

Kështu, vendosja në binarë institucionalë e partneritetit strategjik do t'i shërbente një marrëdhënieje më të qëndrueshme, më efikase, dhe me prioritete të përcaktuara. Ky partneritet ka nevojë të konkludohet, duhet të marrë formë zyrtare!

Marrëdhëniet me Turqinë kanë aq rëndesë sa patjetër do të vijojnë të provokojnë debat, të shihen si me optimizëm dhe me skepticizëm, të ngjallin xhelozira fqinjësh. Por e rëndësishme është që mes dy vendeve të ketë mirëkuptim, të vijojë marrëdhënia tradicionale miqësore. Zyrtarizimi i partneritetit strategjik është veç një pjesë e së tërës; duhet kuptuar se krijimi i një fryme të përgjithshme pozitive është esencial për marrëdhënie të gjata dhe të frytshme shqiptaro-turke.

Mehdi GURRA
Kryetari i Fondacionit Alsar

FOREWORD

Discussing or writing about Albanian-Turkish relations is both easy and hard at the same time. These ever-present relations certainly have had their oscillations over time, affected by developments occurring both within and outside these countries' territories.

Despite of these relations having been faded or intensified in different periods, what has remained unchanged is the reciprocal friendly approach, and considering one another as support.

An extensive analysis of these relations prompted the organization of a scientific conference evolving around these relations. At the conference, diplomats and historians had the opportunity to address Albanian-Turkish relations, and all of them, some more and some less, emphasized the need to strengthen these relations. The Ambassador of the Republic of Turkey, Mr. Murat Ahmet Yörük, greatly helped us, by suggesting the names of Turkish personalities who could participate in this event. We offer our heartfelt gratitude for his collaboration in selecting these personalities. We also thank Mr. Çinar Özen for his willingness to help. It was through his suggestion that we invited an Albanian living in Turkey, the lecturer, Mr. Klevis Kolasi, as a speaker.

The historical context holds an extreme significance if we want to objectively address these relations, but by no means, should we forget the cultural context. The fact that we have walked side by side through history as part of the greatest empire of the time is essential for a realistic analysis, intact from any kind of ghosts. The numerous cultural encounters, the similar way of living, acting, or thinking also favor the friendly relations, maybe even more.

The five hundred-years common history, sometimes, becomes an artificial barrier to friendly relations. A barrier that shows up any time inside and outside opponents renew their hostilities towards this friendship. We delve into the historian's field when we ask to

address and provide conclusions for this century-long coexistence. It is the duty of a serious and objective historian to provide an adequate definition, free of any prejudice and bias, or influenced by the decade-long communist historiography. It is worth underlining that the Ottoman Empire was also an empire of Albanians. This statement is supported by a significant figure: 33 Grand Viziers were Albanians, and many others held high offices. In any case, the identification of the Republic of Turkey with the Ottoman Empire, if not done on purpose, is the mindset of creating an enemy without actually having one.

From the perspective of current developments, when the world is being faced by an unclear future, economic crises, the strengthening of certain global powers and weakening of others; the shifting of power axes, within another cold war environment; with a European Union that is no longer consolidated, as it was 10 or 20 years ago, which is losing Great Britain due to Brexit; in the Balkans where peace and war rise and set together, the Albanian-Turkish close relations need to develop within a strategic partnership framework.

We should have no doubts about our path: it is headed towards the EU. And in this regard, neither Turkey, since it is part of this analysis, is asking for something else. Furthermore, Turkey itself is seeking membership in the European Union. We belong to Europe and no one else pretends otherwise, or insists to impose an eastward belonging. On the contrary, this strengthened relation brings us closer to a regional power and the most powerful Balkan country, with a strong and global voice. It provides us with opportunities to attract economic investments, gives us further assurance, and enables us with a powerful, valuable and needed ally in every aspect.

The strengthening of a warmer and closer relationship between the two countries is of continuous concern to many segments of our society. There are sporadic attempts to undermine such relationship though.

Relationships have two sides, two parties, and thus, reflecting on them should be in harmony. Having a transparent relationship demands reciprocal clarity, careful steps, effective work; it demands understanding and consideration of the situation.

Recognizing realities is the basis for this. Firstly, there is an issue with Turkey making no distinction between Albanians of Albania, Kosovo and Macedonia. If one says "Albanian" in Turkey, the concept is the same, without any differences. Here arises a misunderstanding, a misconception, because Albanians of Kosovo and Macedonia have another kind of formation, have grown in another background, and since they have not experienced the religious ban, like here in Albania, they have been instructed through the ulama's fatwas to maintain the strong relations with Turks, as a Muslim people, and have been advised to enter into marriage relations with them. The common religion has kept them connected; unlike with what happened to Albanians on this side of the border, who suffered the atheist imposition, thus saw the abyss opening in front of them.

It is understandable that Albanians living in the two abovementioned countries consider Turkey very close to them. The uninterrupted physical relation, such as the numerous emigrations of people from Kosovo and Macedonia towards Turkey over the years and decades, population exchanges, marriages, Turkish ethnic minorities in these countries, an almost similar way of living, a traditional presence of the Turkish language, truly make the Albanians of Kosovo and Macedonia brothers to the Turkish people. Hence, the use of the words "fraternal relationships" or naming each other "brothers" is quite appropriate.

The Albanians in Albania come from a different reality, from these relationships' perspective they are almost a separate entity. Indeed, good relations were preserved even during Enver Hoxha's regime. Hoxha himself took special care in selecting the people who would represent our country in Turkey. During the 1980s, for example, the exchange of artistic groups was rather common. However, the relation remained quite official and protocol-based. Later on, during the 1990s, the country was facing extraordinary shortages and was on the verge of collapse. An international operation was conducted to aid the Albanians. The flour, distributed through the "Pelikan" operation, would come from Turkey; the food would come from Europe. However, the Turkish aid was unacknowledged. From here on, a separation ensued. Throughout the years, the relationship would face opposition, the connotation of which was and remains both anti-Turkish and anti-Islam. An opposition that would have its

effect, thus, reminding us of the words of the last Ottoman Shaykh ul-Islam, Mustafa Sabri Efendi, "Unorganized justice fails against organized injustice."

Thus, it is necessary to take into account the distinction between Albanians on both sides of the border. Depicting Albanian-Turkish relations as "friendly" would steer clear of any provocation or efforts to give rise to controversy. In other words, those who want distant relations or no relations at all would be causeless. In addition to that, our Turkish friends would become aware of our country's moderate behavior.

We need an in-depth analysis and observation of Albania and the Albanians' matter in order to avoid any vague judgments or confusion, which would be clearly not beneficial to either party.

Turkish colleges prepared the ground in post-communist Albania and laid foundation after 1992. They were viewed as representatives of Turkey, which was at their best interest as a matter of fact. Albanians believed that it was better embracing Muslims rather than Greeks. Many people struggled making an accurate assessment when Turkey started fighting against these colleges, a whole network of schools, where students were indoctrinated by an organization under the guise of religion, which arranged organized a bloody attempt at mounting a coup d'état in Turkey more than two years ago. It should be admitted that the association of these colleges with the Turkish government has been harmful. Image restoration is imperative and it can be achieved by means of media commitment, publications and academic activities.

More to the point, the provision of accurate information on the Albanian reality to Turkish authorities is essential. Any defective or fancy picture is harmful and does not contribute to strengthening relations of any level. Any deficient assessment takes its toll; therefore it is indispensable to earnestly present facts. Beyond any shadow of doubt, there is room for improvement and reflection.

Although rarely and to a limited extent, the media has striven to properly reflect Albanian-Turkish relations and explain the benevolent approach of Turkey and ensure the no harm will come to us. More often than not, the tendentious spirit of the media is generally the same due to their lower-than-mediocre level.

Multiple Turkish companies are situated in Albania and acting as to an impetus to the country's economy. Multiple Turkish people live and work in Albania, and figures indicate that more people and companies will come from this friendly country. An example of the quality work of Turkish institutions in our country is TİKA - Turkish Cooperation and Coordination Agency. TİKA conducts a broad range of activities and contributes in several fields, and nowadays, it is the illustration of bilateral cooperation.

However, for one reason or another, there is no strong influence on changing the inculcated mentality in spite of their presence in Albania, sponsorship and multiple activities.

Under such circumstances, it is necessary to provide a new alternative by way of the Maarif and Diyanet Foundations, which are two powerful tools of the Turkish government. The work has started, but not on the right pace, and there is a lot of work ahead of us!

Since the beginning, Maarif Foundation was charged with a highly sensitive task when it had to move to a location, previously employed by a notorious Gülenist organization. The Foundation has purchased a chain of schools that can be hardly considered Turkish, whether it be due to the unchanged name, school program or teaching staff, the latter having not been affected by inherent changes. From the perspective of an uninformed person, it is impossible to realize that this chain of schools belongs to Maarif Foundation!

Moreover, let us discuss the Muslim Community of Albania, which is the representative institution of Muslims in our country. Under the sway of the same notorious organization, it continues implementing its policies. This community's leaders and their lost legitimacy sit idle in the MCA headquarters, while the efforts of Muslim believers to have them dismissed have been insufficient, vague and futile. The day when these leaders will be obliged to leave the MCA headquarters, special attention should be dedicated to the new appointments, whom a broad consensus is required for.

Albanian-Turkish relations may be further enhanced if the Turkish appointed staff to Albania knows their history and is qualified and experienced. There is a need to provide a higher degree of efficiency, avoid confusion, unite in action and have a vision.

At the institutional level, upon Edi Rama taking office, both parties declared a strategic partnership with Turkey, which is not official thus far. The approval by the Parliament is indispensable in order to complete the legal framework of such a cooperation agreement. The government heads are expected to sign the strategic partnership agreement during a potential visit of the Turkish president Recep Tayyip Erdoğan, in Tirana. During the visit of the Turkish Minister of External Affairs, Mevlüt Çavuşoğlu, in Tirana this year in mid October, the joint political declaration on the establishment of the Turkey-Albania High Level Cooperation Council was signed, with his counterpart, Ditmir Bushati. The inception of the strategic partnership document for the establishment of this council precedes the joint periodic meetings and joint gatherings of the governments.

Thereby, the institutional regulation of the strategic partnership would contribute to a more efficient, stable and prioritized relation. This partnership needs to be concluded and formalized!

Relations with Turkey bear such significance that they will undoubtedly spark debates, be viewed from an optimistic and skeptic standpoint, and arouse jealousy to the neighboring countries. However, on top of everything, it is important for both countries to understand and have a traditional cordial relationship. The formalization of the strategic partnership is only a cog in the machine and we need to understand that the creation of an overall positive spirit is essential for long and productive Albanian-Turkish relations.

Mehdi GURRA
Chairman of Alsar Foundation

ÖNSÖZ

Arnavut-Türk ilişkileri hakkında konuşmak ya da yazmak aynı zamanda hem kolay, hem de bir o kadar zordur. Kadim olan bu ilişkilerde zaman içerisinde her iki ülke içinde ve dışında meydana gelen gelişmelere bağlı olarak elbette ki dalgalanmalar meydana gelmiştir.

Bu ilişkilerin farklı dönemlerde azaldığına ya da yoğunlaştığına bakmaksızın, karşılıklı dostane yaklaşım ve birbirini destek olarak görme hiçbir zaman değişmeden kalmıştır.

Bu ilişkilerin kapsamlı bir şekilde analiz edilmesi fikri, bizi bu konuda bir bilimsel etkinlik düzenlemeye teşvik etti. Konferansta, Arnavut-Türk ilişkileri hakkında konuşma fırsatı bulan diplomatlar ve tarihçiler, bazıları az bazıları çok miktarda da olsa, her biri bu ilişkilerin güçlendirilmesi ihtiyacına dikkat çekti. Türkiye Cumhuriyeti'nin Tiran Büyükelçisi Sayın Murat Ahmet Yörük, bahse konu etkinliğe katılmak üzere davet edebileceğimiz bazı Türk şahısların isimlerini önermek suretiyle bizlere büyük ölçüde yardımcı oldu. Bu kişilerin belirlenmesindeki işbirliğinden dolayı kendisine kalbi şükranlarımızı sunuyoruz. Aynı zamanda Sayın Çınar Özen'e, yardımlarını esirgemediğinden dolayı teşekkür ederiz. Onun tavsiyesiyle Türkiye'de yaşayan ve çalışan Arnavutlardan biri olan ve eğitmenlik yapan sayın Klevis Kolasi'yi konuşmacı olarak davet ettik.

İlişkileri objektif bir şekilde ele almak istediğimiz takdirde, tarihi içerik son derece önem arz etmektedir. Ancak kültürel içerik de hiçbir surette unutulmamalıdır. Dönemin en büyük imparatorluğunun bir parçası olarak tarihte türlü zorluklara rağmen beraber yan yana yürümüş iki toplum olduğumuz gerçeği, tutarlı bir analiz için esastır. Çok sayıda kültürel karşılaşma, birçok benzer yaşama, hareket etme ve düşünme tarzları, bu dostane ilişkilerin lehinde olmuş, hatta belki de bundan daha fazlasını teşkil etmiştir.

Beşyüz yıllık ortak geçmiş bazen bu dostane ilişkiler için yapay bir engel haline gelebilmektedir. Bu ilişkilere yönelik düşmanlıklarını yenileyen iç ve dış hasımlar ortaya çıkmıştır. Asırlar boyu süren bu birlikte yaşam hakkında konuşmak ve sonuç çıkarmak istediğimizde tarihçinin alanına girmiş oluruz. Ciddi ve objektif, önyargısız, tarafsız ve komünist yılların tarih yazımından etkilenmemiş uygun bir tanım vermek tarihçinin görevidir. Osmanlı İmparatorluğu'nun, Arnavutların da imparatorluğu olduğunun altını çizmemiz gerekir. Bu ifadeyi önemli istatistiki bir bilgi desteklemektedir: Osmanlı İmparatorluğu'nda 33 vezir-i azam Arnavut kökenli idi ve Arnavutlardan diğer birçokları da yüksek mevkilerde hizmet etmişlerdi. Her halükarda Türkiye Cumhuriyeti'nin Osmanlı İmparatorluğu ile kimlik belirlemesi, eğer kasıtlı değilse, var olmayan bir düşman yaratma zihniyetidir.

Bugünkü gelişmelere göre, dünyanın geleceği ile ilgili belirsizlik, ekonomik kriz, bazı küresel güçlerin güçlenmesi ve diğer bazılarının zayıflığı, güç eksenlerinin yer değiştirmesi, başka bir Soğuk Savaş ortamında, geçmiş on ila yirmi yılda konsolide olmamış ve Brexit'ten dolayı Büyük Britanya'yı kaybeden bir Avrupa Birliği (AB) ile barış ile savaşın birlikte alçalıp yükseldiği Balkanlarla karşı karşıya geldiği bir sırada Arnavut-Türk yakın ilişkilerinin stratejik ortaklık çerçevesinde geliştirilmesi gereklidir.

AB'ye yönelmiş yolculuğumuz hakkında şüphemizin olmaması gerekir; çünkü bu bağlamda, bu analizin bir parçası olan Türkiye de bizden farklı bir şey istememektedir. Dahası, o da (Türkiye) Avrupa Birliği'ne üye olmak istemektedir. Biz Avrupa'ya aitiz ve hiç kimse bunun aksini iddia etmemekte ve Doğu'ya aidiyeti dayatmayı amaçlamamaktadır. Tersine, bu güçlendirilmiş ilişki bizi bölgesel bir güç, ve yüksek küresel bir sese sahip en güçlü Balkan ülkesiyle yakınlaştırmaktadır. Bu, ekonomik yatırımları çekme imkanları temin etmekte, daha fazla güvenceler vermekte, ve bize güçlü, değerli ve her bakımdan yanımızda olacak bir müttefik sağlamaktadır.

İki ülke arasındaki sıcak ve yakın ilişkilerin güçlendirilmesi toplumumuzun bazı kesimleri için sürekli bir alaka teşkil etmektedir. Yine de böylesi bir ilişkiyi baltalamak için münferit girişimler vardır.

İlişkilerin iki yanı, iki tarafı vardır ve bunun yansıması uyum içinde olmalıdır. Şeffaf ilişkilere sahip olma karşılıklı netlik, dikkatli adımlar, verimli çalışma, durumu anlama ve değerlendirme gerektirmektedir.

Bunun temeli, gerçekleri bilmektir. İlk olarak, Türkiye, Arnavutluk, Kosova ve Makedonya Arnavutları arasında bir fark görmemektedir. Türkiye'de "Arnavut" dediğinizde, hiçbir ayırım olmadan algılama aynıdır. Burada bir yanlış anlama ve yanılgı oluşmaktadır; çünkü Kosova ve Makedonya Arnavutları farklı bir biçimlendirmeye sahipler, farklı bir arkaplanda yetiştiler ve Arnavutluk'taki gibi din yasağını tecrübe etmediler, Müslüman bir toplum olarak Türklerle güçlü bağları sürdürmek için ulema fetvalarıyla yönlendirildiler, Türklerle evlenmeleri yönünde teşvik edildiler. Sınırın öte yanındaki Arnavutların yaşadığı ateist dayatmanın aksine ortak dini inanç onları birbirine bağlı tuttu.

Yukarıda bahsedilen iki ülkede yaşayan Arnavutların Türkiye'yi kendilerine çok daha yakın görmeleri anlaşılabilirdir. Kosova ve Makedonya'dan çok sayıda kişinin on yıllar boyunca Türkiye'ye göç etmesi, nüfus mübadeleleri, evlilikler, bu ülkelerdeki Türk azınlıklar, neredeyse aynı olan yaşam biçimi ve Türk dilinin geleneksel varlığı gibi kesintiye uğramamış fiziki ilişkiler, Kosova ve Makedonya Arnavutlarını gerçekten de Türkler ile kardeş kılıyor. Bu yüzden "kardeşlik ilişkileri" kelimelerinin kullanımı ya da birbirlerini "kardeş" olarak nitelendirmek tam yerinde bir tabirdir.

Arnavutluk'taki Arnavutlar bu ilişkiler perspektifinden başka bir gerçekliğe aittirler, neredeyse ayrı bir oluşumdurlar. Türkiye ile olan iyi ilişkiler gerçekten de Enver Hoca rejimi sırasında da korundu. Özellikle ülkemizi Türkiye'de temsil eden insanların seçilmesiyle Hoca bizzat kendisi ilgilendi. 1980'lerde sanat gruplarının iki ülke arasında geliş gidişi genel bir örnekti. İlişkiler yine de daha resmi, daha protokol temelliydi. Ardından 1990'larda ülke olağanüstü eksikliklerle karşılaşıyor ve yıkılmanın eşiğinde bulunuyordu. Arnavutlara yardım için uluslararası bir operasyon ulaştı. Un, "Pelikan" operasyonu aracılığıyla Türkiye'den, gıda Avrupa'dan gelecek ve dağıtılacaktı. Ancak Türk katkısının kaynağı belirtilmedi. Buradan bir ayrılık başladı. Yıllar içerisinde ilişkiler muhalefet ile karşılaşacaktı. Bunun çağrışımı ise Anti-Türk ve Anti-İslam idi ve öyle kaldı. Bu, muhalefetin etkisiyle olacaktı ve bize son Osmanlı Şeyhülislamı Mustafa Sabri Efendi'nin "Organize edilmemiş adalet, organize edilmiş adaletsizlik karşısında yenilgiye uğrar" sözlerini hatırlatmaktadır.

Sınırın iki tarafındaki Arnavutlar arasındaki farklılığı göz önünde bulundurmak gereklidir. Arnavutlar ve Türkler arasındaki ilişkileri

'dostane' olarak tanımlamak herhangi bir provokasyonu ve münakaşayı önleyecektir. Diğer bir deyişle, uzak ilişkiler arzu eden veya hiç ilişki istemeyenleri nedensiz bırakacaktır. Buna ek olarak, bizim Türk dostlarımızda ülkemizin ılımlı bir davranış biçimi ile farkındalık oluşacaktır.

Arnavutluk ve Arnavutların meseleleri hakkında her iki tarafa yarar sağlamayacak herhangi muğlak bir yargılamadan veya kafa karışıklığından kaçınmak için derinlikli bir analize ve gözleme ihtiyacımız var.

Komünizm sonrası Arnavutluk'ta Türk kolejleri zemini hazırladılar ve 1992 yılından sonra kurulmaya başladılar. Onlar, Türkiye'nin temsilcileri olarak görülüyor, hakikaten de bu şekilde algılanmayı istiyorlardı. Arnavutlar Yunanlı yerine Müslümana kucak açmanın daha iyi olduğuna inanıyorlardı. İki yıl önce Türkiye'de kanlı darbe girişiminde bulunan, din kisvesi altında gizlenen ve öğrencilerin beyninin yıkandığı bütün okulların bir şebekesi olan bu kolejlere karşı Türk devleti tarafından savaş açıldığında, doğru bir değerlendirme yapmada zorlanıyorlardı. Bu kolejlerin Türk devleti ile çağrışım yapmasının zararlı olduğunu kabul etmek gerekir. Bir imaj yenileme zorunludur ve bu medya vasıtasıyla, yayınlarla, akademik faaliyetlerle sağlanabilir.

Arnavut gerçekliğinin Türk yetkililere doğru iletilmesi daha da önemlidir. Kusurlu veya süslü bir resim zarar getirir ve hangi seviyede olursa olsun ilişkilerin güçlendirilmesine hizmet etmez. Her bir yetersiz değerlendirme büyük zarar verir. Bu yüzden mevcut gerçeklerin ciddiyetle sunulması kaçınılmazdır. Kuşkusuz, tekamüle ve tefekküre kesinlikle yer vardır.

Nadiren ve az da olsa, medya Arnavut-Türk ilişkilerini gerektiği gibi yansıtmaya, Türkiye'nin iyi niyetli yaklaşımını anlatmaya ve onlardan bizlere hiçbir kötülüğün gelmeyeceğini açıklamaya çalıştı. Çoğu kez medyanın taraflı ruhu, orta ve alt seviyelerine karşın genellikle aynıdır.

Arnavutluk'ta birçok Türk şirketi bulunmakta ve ülkenin ekonomisine ivme kazandırmaktadır. Burada birçok Türk yaşamakta ve çalışmaktadır, ve rakamlar bize bu dost ülkeden daha fazla insan ve şirketin geleceğini göstermektedir. Ülkemizde, olağanüstü iyi iş çıkaran Türk kurumlarından bir örnek Türk İşbirliği ve Koordinasyon

Ajansı Başkanlığı'dır (TİKA). TİKA, geniş bir yelpazede faaliyetler yürütmektedir ve bir çok alanda katkı sağlamaktadır ve günümüzde ikili işbirliğinin bir örneğidir.

Bununla beraber, bir veya birden fazla sebepten ötürü, sponsorlukları ve çok yönlü faaliyetleriyle Arnavutluk'taki mevcudiyetine karşın kökleşmiş bir zihniyetin değiştirilmesine yönelik güçlü bir etkisi yoktur.

Bu şartlar altında, Türk hükümetinin iki güçlü aracı olan Türkiye Maarif Vakfı ve Diyanet İşleri Başkanlığı aracılığıyla yeni bir alternatif temin etmek gereklidir. Çalışmalar başladı, ama bunlar henüz doğru tempoda değil ve önümüzde daha yapacak çok iş var!

Başlangıçtan beri, Türkiye Maarif Vakfı'nın, kötülüğüyle ün salmış Gülenci yapının faaliyet gösterdiği bir çevreye yerleşmede oldukça hassas bir görevi bulunmaktadır. Vakıf, değişmemiş isim, eğitim müfredatı öğretim kadrosundan dolayı halen Türk okulları olarak görülmesi zor olan bir okullar zinciri satın aldı. Dışarıdan, bilgi sahibi olmayan bir kişinin gözünden bu haliyle bu okullar zincirinin Maarif Vakfı'na ait olduğunun anlaşılması mümkün değildir!

Dahası, ülkemizdeki Müslümanların temsil edildiği kurum olan Arnavutluk Müslüman Topluluğu'ndan (Diyanet İşleri) bahsedelim. Kötülüğüyle ün salmış yapının eline düşen bu kurum, Gülenci yapının politikalarının uygulayıcısı olmaya devam etmektedir. Meşruiyetini kaybetmiş bu Topluluk yöneticileri, Topluluğun merkezinde boş otururken, Müslümanların bu kişilerin koltuklarından ayrılmalarına yönelik çabaları yetersiz, belirsiz ve sonuçsuz kalmıştır. Bu yöneticilerin, Arnavutluk Müslüman Topluluğu'ndaki ofislerini bırakmak zorunda kaldıkları gün, üzerinde olabildiğince geniş fikir birliği olması gereken yeni atamalara özel bir dikkat gösterilmesi gerekir.

Arnavut ve Türkler arasındaki ilişkiler, buraya getirilen Türk personeli kendi tarihini bildiği, kalifiye ve tecrübeli olduğu takdirde, daha fazla gelişme ve ilerleme kaydedebilir. Yüksek seviyede liyakat, verimlilik, karmaşadan kaçınma, eylemde birlik ve vizyona gerek vardır.

Kurumsal düzeyde, Edi Rama'nın iktidara gelmesiyle birlikte, Türkiye ile her iki tarafın da kabul ettiği, ancak henüz resmileştirilmemiş bir stratejik ortaklık ilanı yapıldı. Meclis tarafından oylamayla kabul edilmesi, bu düzeydeki işbirliğin yasal çerçevesinin tamamlanması

için kaçınılmazdır. Stratejik ortaklık anlaşmasının devlet başkanları tarafından imzalanmasının, Türkiye Cumhurbaşkanı Recep Tayyip Erdoğan'ın Tiran'a yapacağı bir ziyaret sırasında gerçekleşmesi beklenmektedir. Türkiye Dışişleri Bakanı Mevlüt Çavuşoğlu'nun, Ekim ayının ortalarında gerçekleştirdiği Tiran ziyareti sırasında Arnavutluk mevkidaşı Ditmir Bushati ile Türkiye-Arnavutluk Üst Düzey İşbirliği Konseyi'nin kurulmasına ilişkin ortak siyasi bildirgeyi imzaladı. Bu konseyin kurulması için stratejik ortaklık belgesinin başlatılması öncesinde iki hükümetin düzenli görüşmeleri ve ortak toplantıları gerçekleşti.

Bu sayede, stratejik ortaklığın kurumsal düzenlemesi daha istikrarlı, daha verimli ve tanımlanmış önceliklere katkı sağlayacaktır. Bu ortaklığın sonuçlandırılması ve resmi bir çerçeve alması gerekmektedir!

Türkiye ile olan ilişkiler, muhakkak tartışmalar yaratacak, iyimser ve şüpheci bir bakış açısından görülecek ve komşu ülkeler arasında kıskançlık yaratacak kadar önem taşımaktadır. Bununla beraber, herşeyin üzerinde olarak her iki ülke için geleneksel dostane bir ilişkiye sahip olunduğunu anlamak çok önemlidir. Stratejik ortaklığın resmileştirilmesi bütünün sadece küçük bir parçasıdır. Uzun ve verimli Arnavut-Türk ilişkileri için genel olumlu bir havanın oluşturulmasının esas olduğunu anlamamız gereklidir.

Mehdi GURRA

"ALSAR" Vakfı Başkanı


ARNAVUT-
TÜRK
İLİŞKİLERİ
Marrëdhëniet
Shqiptaro-
Turke
ALBANIAN-TURKISH RELATIONS
Arnavut-Türk İlişkileri



FTESE

Fondacioni "ALSAR" ka nderin dhe kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në simpoziumin me temë "Marrëdhëniet shqiptaro – turke " që do të zhvillohet **ditën e Mërkurë më datë 09 maj 2018 ora 10°° në Hotel "Tirana International" Salla "Balsha".**

Ju mirëpresim !

PROGRAMI

Fjale e hapjes: Kryetari i Fondacionit Alsar
Z. Mehdi Gurra

Fjalë përshëndetëse: Ambassador i Republikës së Turqisë
SH. T. Z. Murat Ahmet Yörük

Referati 1.
Marrëdhëniet shqiptaro-turke
në periudhën e viteve 1923-1938
Prof. Dr. Bülent AKYAY

Referati 2.
"Realitete të marrëdhenieve
shqiptaro - turke ndër vite"
Dr. Halil HYSENİ

Referati 3.
Shqipëria në politikën ballkanike të Turqisë;
Një vlerësim historik
Prof. Dr. Çınar ÖZEN

Referati 4.
Konteksti rajonal
i aleancës strategjike Shqipëri-Turqi
''Mjeshtër i madh në Diplomaci" Shaban MURATİ

Referati 5.
Turqia dhe Ataturku në shtypin shqiptar
të viteve '20 - '30 të shekullit të XX-të
Prof.Dr. Ferit DUKA

Referati 6.
Problemet që ka hasur Shqipëria që prej
viteve 90-të e deri në ditët e sotme dhe roli i Turqisë
Dr. Klevis KOLASI

RSVP:042241852



INVITATION

It is an honor and pleasure for "ALSAR" Foundation to invite you to the symposium titled "Albanian–Turkish Relations" **on Wednesday, May 9th 2018, 10°° at "Tirana International" Hotel, "Balsha" Conference Room.**

We are looking forward to seeing you!

AGENDA

Opening speech: by the Head of ALSAR Foundation
Mr. Mehdi Gurra
Greetings: Ambassador of the Republic of Turkey
H. E. Mr. Murat Ahmet Yörük

Speech 1.
Albanian-Turkish Relations
during the period 1923-1938
Prof. Dr. Bülent AKYAY

Speech 2.
The Reality of Albanian-Turkish Relations
over the Years
Dr. Halil HYSENİ

Speech 3.
Albania in Turkey's Balkan politics.
Historical Assessment
Prof. Dr. Çınar ÖZEN

Speech 4.
Regional Context of the Strategic
Alliance between Albania and Turkey
"Great Master in Diplomacy", Mr. Shaban MURATİ

Speech 5.
Albania and Atatürk in the Albanian Press
during the '20-'30s of the XX Century
Prof. Dr. Ferit DUKA

Speech 6.
Problems encountered by Albania since the 1990s
until today and the role Turkey has played
Dr. Klevis KOLASI

RSVP:042241852

9 MAJ 2018 / 9 MAY 2018 / 9 MAYIS 2018


Marrëdhëniet
shqiptaro
Turke








Marrëdhëniet
shqiptaro


Marrëdhëniet
shqiptaro-
Turke
ALBANIAN-TURKISH RELATIONS

FJALA E HAPJES



Z. Mehdi Gurra
Kryetari i Fondacionit Alsar

E nderuar Prefekte e Tiranës. Znj. Suzana Jahollari
Shkëlqesi Ambasador i Republikës së Turqisë Z. Murat Ahmet Yörük.
Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik të akreditуar në vendin tonë!
Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore.
Drejtues të organizatave të shoqërisë civile!
Të nderuar pjesëmarrës, miq dhe të ftuar!

Ju përshëndes në emër të Fondacionit ”Alternativa e së Ardhmes” duke ju falenderuar për nderin dhe respektin që treguat me pjesëmarrjen tuaj në këtë veprimtari.

Të nderuar pjesëmarrës!

Simpoziumi i sotëm shkencor i kushtohet trajtimit të një prej periudhave më të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare rajonale të Shqipërisë siç janë marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Turqisë.

Ndaj për ndriçimin e dinamikës dhe rëndësisë së ketyre marrëdhënieve janë ftuar të flasin personalitete të cilat i kanë kushtuar studimet dhe hulumtimin e tyre shkencore këtyre marrëdhënieve.

Shqiptarët dhe turqit kanë qenë në një udhë për një kohë të gjatë në histori. Shekuj të tërë bashkëjetese nën ombrellën e Perandorisë

Osmane, kanë farkëtuar një miqësi të qëndrueshme, të sinqertëdhe të dobishme reciprokisht. Një miqësi e vijuar në shekullin e njëzetë, për të ardhur deri tek partneriteti strategjik i dekadës së fundit.

Historitë e të dy vendeve janë shembull i mirë se si mund të bashkëveprojnë qytetërimet e ndryshme me njëri-tjetrin, dhe se si mund të japin dhe marrin ata ndërmjet tyre. Qytetërimi islam të cilin në Ballkan e sollën turqit osmanë, ka lënë gjurmë të thella në të gjitha sferat e jetës se popullit shqiptar, praninë dhe ndikimin e këtij qytetërimi sot e gjejmë në besim, art, arkitekturë, folklor dhe në gjuhë".

Shqiptarë të panumërt do të linin gjurmë në historikun e Perandorisë Osmane si kontribues të gjithfarshëm, nga mbajtës të posteve më të larta qeverisëse, në ndihmues të mbarëvajtjes së përgjithshme. Miliona shtetas turq me origjinë shqiptare kontribuojnë sot në mbarëvajtjen e vendit të tyre, Turqisë, duke qenë njëkohësisht një urë e fuqishme në marrëdhëniet vëllazërore midis dy popujve.

Historia shpesh e përbashkët, mënyra e ngjashme e jetesës, filli i përbashkët religjioz, lidhjet e ndërsjellta familjare, komunikimi i vazhdueshëm dhe i dendur, lidhjet ekonomike dhe kulturore, janë një ushqim i pashtershëm për forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke.

Ashtu si në të shkuarën, Turqia i është gjendur gjithmonë pranë Shqipërisë në këto thuajse tre dhjetëvjeçarë, që me rënien e sistemit totalitar. Ky vend qe thuajse i vetmi pas 1990-s që u mundësoi shqiptarëve pa asnjë lloj kushtëzimi lëvizjen e lirë, të shfrytëzuar dendur prej tyre si për turizëm, tregti, arsimim, mjekim, e më tej. Në momente kyç për shqiptarët, si në ngjarjet famëkeqe të vitit 1997, apo në konfliktin në Kosovë pak më vonë, Turqia do të ishte në krah të tyre në çdo aspekt, nga mbështetja verbale te ndihma e drejtpërdrejtë.

Vizitat e njëpasnjëshme të krerëve më të lartë qeverisës në këto vite në Turqi apo Shqipëri, si nga njëra palë dhe tjetra, takimet mes tyre në forume ndërkombëtare, si dhe deklaratat përkatëse, do t'i mëshonin kësaj miqësie vëllazërore, kësaj ndërlidhjeje të pandashme të jetëve tona në të tëra dimensionet, në atë shoqëror, politik, ekonomik, gjeostrategjik.

I ndjeri Turgut Ozal, gjatë vizitës që zhvilloi në vendin tonë, do të nënvizonte se:

You are all closely aware of the misery that the terrorist organization FETÖ sealed on July 15, 2016, directly threatening national security and rule of law. Of the seemingly legal extensions of this organization, which that day killed 250 innocent citizens and injured thousands of others. Persons belonging to this organization continue to maintain their presence in Albania.

This traitor terrorist organization has been planting its roots in the Albanian education, health system, religious institutions and the private sector since 1991 and continues to do so.

Knowing and openly seeing what the FETÖ organization did to Turkey, we believe that it constitutes a threat and risk to the Albanian national security. That is why the Albanian land should be cleared of FETÖ elements and persons related to it, who have been feeding it

with hostility and hatred towards Turkey. This is also in the interest of Albania itself. It is our fair expectation. In conclusion of my speech, I would like to reiterate for your pleasure that the Turkish – Albanian friendship and the common interests of our people have laid the foundations for the connection between our hearts and our determination to go forward. Given the occasion, I would like to give special thanks to our friend, Mr. Mehdi Gurra, President of "Alsar" for organizing this scientific symposium on the Turkey – Albania relations. I would like to greet you all with heartfelt sentiments and respect!

Long live the Turkish-Albanian brotherhood!

Long live the Turkish-Albanian friendship!

TÜRKİYE CUMHURİYETİ TİRAN BÜYÜKELÇİSİNİN SELAMLAMA KONUŞMASI

Sayın Murat Ahmet Yörük

Mirëmëngjes!
Sayın Kordiplomatik mensupları,
Sayın Vali,
Sayın Kukes Belediye Başkanı,
Sayın Arnavutluk Bektaşileri Başdedesi Mondi Hazretleri,
Değerli akademisyenler ve sevgili öğrenciler,
Değerli STK temsilcileri,
Arnavutluk medyasının kıymetli basın mensupları,
Hanımefendiler, Beyefendiler ve Türklerin kalbinde taht kurmuş Arnavut kardeşlerimiz,

Alsar Vakfı tarafından düzenlenen ve Türkiye ile Arnavutluk'tan değerli akademisyenlerin katıldığı "Arnavutluk-Türkiye İlişkileri" başlıklı sempozyumda, bu güzide dinleyici kitlesine hitap etmekten büyük onur duyuyorum. Balkanlar, coğrafi, siyasi ve ekonomik açıdan olduğu kadar tarihi, kültürel ve insani bağlar bakımından da Türkiye için büyük önem taşımaktadır. Balkanların ve Balkanlardaki barış ve istikrarın temel sütunlarından biri de hiç kuşkusuz Arnavutluk ve Arnavutlardır. Balkan ülkeleri arasında Arnavutluk'la ilişkilerimiz altı asrı aşan köklü ve parlak bir geçmişe sahiptir. Dostluk tohumlarımız Sultan I. Murat döneminde, 1385 yılında Arnavutluk'un güneyinde Savra ovasında atılmıştır. Osmanlı arşivlerindeki en eski defterler Arnavutluk'a ait olup 1431-1432 tarihlerine dayanmaktadır. Ortak tarihimizde Arnavutlar, Osmanlı Devleti'ne en çok Sadrazam yani Başbakan veren millet olmuştur. Nitekim 32-35 arasında Sadrazam'ın Arnavut kökenli olduğu tarihsel olarak bilinmektedir.

Diğer yandan Otranto seferini yapan efsane komutan Gedik Ahmet Paşa, İstanbul'un göz bebeği Sultan Ahmet Camii'nin mimarı Elbasanlı Sedefkar Mehmet Ağa, İstanbul Üniversitemizin kurucusu ve Rektörü Hoca Hasan Tahsini, ilk roman ansiklopedi ve sözlük çalışması yapan Şemsettin Sami Fraşeri, Galatasaray Spor Kulübü'nün kurucusu Ali Sami ve burada saymakla bitiremeyeceğim binlerce bilindik sima, Arnavut kökenlidir. Şurası açıktır ki, Arnavutlar sanatta, edebiyatta, bürokraside, akademik alemde ortak tarihimize damga vurmuşlardır. Osmanlı'nın asıl unsuru olmuşlardır.

Osmanlı da Arnavutların yaşadığı toprakları korumuştur. Arnavut milletinin mevcudiyetinin güçlenmesine adeta kol kanat germiştir. Arnavutluk'un bağımsızlık ilan etmesi elbette iki halk arasındaki dostluk ve kardeşliğin kesilmesi anlamına gelmemiştir. Asırlarca birlikte yürümüş, hayat ve kader birliği yapmış iki millet arasındaki bu kuvvetli bağ ve duygular, gelişimini sürdürmüştür. İki ülke aynı anda milli mücadele verirken ve emperyal devletlere karşı savaşırken Mustafa Kemal Atatürk'ün 9 Aralık 1920 yılında Kurmay Albay Selahattin Sait Bey ile bir askeri heyeti, Arnavutluk ordusunu modern anlamda eğitmek üzere Arnavutluk'a göndermesi bunun somut bir örneğidir. Aynı Selahattin Sait Bey daha sonra, Arnavutluk'ta Savunma Bakanlığı da yapacaktır. Arnavutluk'u hiçbir zaman yabancı bir memleket ve Arnavutları kendimizden başka bir millet telakki etmediğimizi Gazi Mustafa Kemal, "Biz Arnavut milletini severiz, kardeş tanırız, kendimizden uzak görmeyiz" sözleriyle ilan etmiştir. Cumhurbaşkanımız Recep Tayyip Erdoğan ise 13 Mayıs 2015'te Arnavutluk'a yaptıkları resmi ziyarette, "Ülkemizde yaşayan milyonlarca Arnavut kökenli vatandaşımız siyasetten ticarete, spordan sanata her alanda Türkiye'ye katkı vermektedir. Biz 600 yıldır Arnavut kardeşlerimizle beraber bugünlere geldik, beraber geleceğe yürüyoruz" diyerek aslında her şeyi özetlemiştir. Arnavutluk'la ilişkilerimiz hiç şüphesiz komünizm dönemini takiben siyasi, ekonomik, askeri, kültürel ve diğer tüm alanlarda büyük ilerleme kaydetmiş, üst düzey ve teknik ziyaretlerle de pekişmiştir.

Değerli misafirler,

Ekonomik alanda ikili ticaret hacmimiz 2017 yılında 500 milyon dolara yaklaşmıştır. Ülkemiz halihazırda Arnavutluk'un ikinci

en büyük ithalat ortağı konumundadır. Yeterli midir? Hayır! Biz gerçekten bu rakamların gerçek potansiyelimizi yansıtmadığını düşünüyoruz. İkili ticaret hacminin en kısa süre içerisinde en az 1 milyar dolara çıkmasını hedefliyoruz. Arnavutluk'taki Türk firmaların sayısı 400 civarındadır ve bu firmalarımızın yatırım değeri 2,7 milyar doları aşmıştır. Bu firmalarımızın istihdam ettiği Arnavut kardeşlerimizin sayısı 15.000'e yaklaşmaktadır. Enerji, bankacılık, telekomünikasyon, lojistik, madencilik, liman işletmeciliği gibi stratejik sektörlerde faaliyet göstermekte olan yatırımlarımızı en kısa sürede genişletmeyi de hedefliyoruz.

Bu minvalde Türk işadamlarımızı Arnavutluk'ta daha fazla yatırım yapmaya da teşvik ediyoruz. İnşallah Cumhuriyetimizin 100. Kuruluş yıldönümünü kutlayacağımız 2023 yılında ise Arnavutluk'taki yatırım değerimizi çift haneli rakamlara çıkarmayı ve Türk şirketleriyle Arnavut kardeşlerimize sağladığımız istihdam rakamını ise 50.000'e çıkarmayı hedefliyoruz. Bölgesinde söz sahibi, istikrarlı bir Arnavutluk olmasını istiyoruz. NATO Müttefikimiz Arnavutluk'u Balkanlar'da barış ve istikrarın teminatı olarak görüyoruz. Avrupa Birliği'yle bütünleşme sürecinde kaydettiği ilerlemelerden memnuniyet duyuyoruz. Zira Arnavut kardeşlerimizin en iyiyi hak ettiğine inanıyoruz. Temenni ediyoruz ki tüm bu samimi gayretler Arnavutluk'un bu yıl içerisinde Avrupa Birliği'ne katılım müzakerelerine başlamasıyla neticelensin.



Sayın Protokol,

Değerli konuklar,

Türkiye'nin milli güvenliğini ve kamu düzenini doğrudan doğruya tehdit eden Fethullahcı terör örgütünün 15 Temmuz 2016 tarihinde ülkemizde nasıl bir vahşete imza attığını hepiniz yakinen biliyorsunuz. Anılan tarihte yalnızca bir gecede 250 masum vatandaşımızı katleden ve binlercesini yaralayan, sakat bırakan, bu örgütün yasal görünümlü uzantıları ve örgüt mensubu şahısları, Arnavutluk'taki mevcudiyetlerini sürdürmektedirler. Bu hain terör örgütü eğitimde, sağlıkta, dini kurumlarda ve özel sektörde Arnavutluk'ta komünizmin çöktüğü 1991 yılından bu yana kök salmış durumdadırlar. FETÖ'nün Türkiye'de yaptıkları biliniyor ve ortadayken, örgütün dost ve kardeş olarak gördüğümüz Arnavutluk'un ulusal güvenliği için de tehdit ve tehlike oluşturduğunu düşünüyoruz. Dolayısıyla Arnavut topraklarının, Türkiye'ye husumet ve kin besleyen FETÖ unsurlarından ve ona bağlı kişilerden arındırılması gerekiyor. Bu aynı zamanda Arnavutluk'un kendi menfaatinedir. Bizim de haklı beklentimizdir.

Sözlerime son verirken Türkiye-Arnavutluk dostluğunu, halklarımızın müşterek çıkarları ve kalbi bağları temelinde daha ileri götürmeye yönelik kararlılığımızı bir kez daha huzurlarınızda yinelemek istiyorum. Bu vesileyle Türkiye-Arnavutluk İlişkileri sempozyumunu düzenleyen Alsar Vakfı'nın çok kıymetli Başkanı Sayın Mehdi Gurra'ya da huzurlarınızda hassaten teşekkür etmek istiyorum. Hepinizi en kalbi duygularımla ve saygıyla selamlıyorum.

Yaşasın Türkiye-Arnavutluk kardeşliği!

Yaşasın Türkiye-Arnavutluk dostluğu!.

"MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE NË PERIUDHËN E VITEVE (1923-1938).



Prof. Dr. Bülent AKYAY

I nderuar Kryetar
I nderuar Protokoll
Të nderuar pjesëmarrës

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këtë simpozium, sidomos Kryetarine Fondacionit "ALSAR" zotëri Mehdi Gurra. Unë do të përpiqem për të trajtuar në kumtesën time temën "Marrëdhëniet Shqipëri Turqi midis viteve 1923-1938" aq sa më premton koha.

Marrëdhëniet Politike Turqi-Shqipëri në vitin 1923.

Pas ndarjes se Shqipërisë nga administrata osmane qindra mijëra njerëz me origjinë shqiptare kishin qëndruar në Turqi. Këtu përfshihen edhe shqiptarët të cilët e zgjodhën Turqinë për emigrim nga Kosova, Maqedonia dhe Greqia pas presionit Jugosllav dhe Grek. Qeveria shqiptare u vu në lëvizje, për të zgjidhur problemet e shqiptarëve në Turqi dhe për të rregulluar marrëdhëniet politike me Turqinë, e cila u formua si rezultat i Luftës turke për pavarësi.

Përfaqësuesi i Shqipërisë në Beograd në mes të qershorit të vitit 1923, i përcolli përfaqësuesit të Turqisë në Beograd, kërkesën e qeverisë së tij për të vendosur marrëdhënie politike me qeverinë e Ankarasë. Pas marrjes së mendimit të favorshëm nga Ankaraja, përfaqësuesi turk i raportoi përgjigjen përfaqësuesit shqiptar. Pas kësaj, qeveria turke për fillimin e marrëdhënieve politike mes dy vendeve nga Qeveria e Shqipërisë, filluan të presin për të dërguar delegacionin në Ankara kurse qeveria shqiptare filloi përgatitjet për vendosjen e marrëdhënieve politike me Turqinë.

Qeveria e Shqipërisë, për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Turqinë, themeloje një komision të kryesuar nga Eshref Bej Frashëri, dhe të përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri i Jashtëm XhaferVilla dhe Nezir Leskoviku. Delegacioni shqiptar, i cili mbërriti në Stamboll më 17 tetor 1923, është mirëpritur nga një numër i madh i qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Stamboll së bashku me autoritetet turke. Delegacioni u transferua në Ankara më 23 tetor me tren. Në Ankara, çështja e regjimit politik ende nuk ishte zgjidhur. Në këtë mjedis, ku kriza qeveritare kishte filluar, delegacioni turk nuk do të ishte në gjendje të formontenjë komision për negociata për shkak edhe të sëmundjes së ministrit të jashtëm Ismet Pasha. Delegacioni shqiptar gjithashtu u përpoq të vlerësojë këtë periudhë duke shpjeguar tezat shqiptare në bisedimet dypalëshe.

Shefi i delegacionit shqiptar Eshref Frashëri, i përmblodhi Kryeministrit Fet'hi (Okyar) Beut objektivat e vizitës ku ishin vendosja e marrëdhënieve diplomatike mes dy shteteve, po ashtu njohja e konsullatës shqiptare që ishte në Stamboll si dhe njohja e shtetësisë së shqiptarëve që jetonin në Turqi si shtetas shqiptar.

Megjithatë, delegacioni shqiptar nuk mori mbështetje nga Fet'hi Beu për çështjet e shtetësisë. Gjithashtu u përkujtua se qeveria turke konsideroi parakushtin e nënshkrimit të një traktati miqësie si një parim i domosdoshëm për të nisur marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve. Delegacioni shqiptar nuk u shqetësua dhe nuk e shihte si problem për të bërë një traktat miqësie për të vendosur marrëdhënie diplomatike. Delegacioni i bëri këto negociata në turqisht.

Delegacioni shqiptar, insistonte në shtetësinë e shqiptarëve të shpërngulur para Luftërave Ballkanike dhe të ardhur në Turqi si dhe të atyre që erdhën nga Shqipëria e jugut pas presionit nga Greqia.

Kryeministri shqiptar Ahmet Zogu, me rastin e shpalljes se Republikës së Turqisë dhe zgjidhjes president të Mustafa Kemal Pasha më 31 tetor 1923 i ka dërguar kryeministrit Fet'hi Bey një telegram urimi. Më 1 nëntor 1923 kryeministri i Republikës së Turqisë Ismet Pashës, në të njëjtën ditë e ka pranuar delegacionin shqiptar.

U krijua një delegacion turk për lidhjen e një traktat miqësie me delegacionin shqiptar në Ankara, për rregullimin e kontratës së qëndrimit dhe një marrëveshje mbi çështjet e kombësisë. Konferenca midis delegacioneve turke dhe shqiptare u hap më 10 nëntor 1923. Traktatet e miqësisë u pranuan në bisedime. U caktuan nëntë nene në lidhje me parimet e Marrëveshjes së Qëndrimit. Gjithashtu u bisedua edhe për çështjet e shtetësisë.

Si rezultat i negociatave, marrëveshjet e miqësisë dhe qëndrimit përfunduan pa ndonjë problem, vetëm nënshkrimet duhej të hidheshin. Megjithatë, mosmarrëveshja mbi shtetësinë bëri që delegacioni shqiptar t'i ndalë bisedimet. Delegacioni shqiptar kishte insistuar qysh në fillim te bisedimeve në miratimin e dyshtetësisë se shqiptarëve nga Shqipëria dhe shqiptarët që jetojnë në Turqi si dhe insistuan në njohjen e të drejtës për të zgjedhur ata që duan të riatdhesohen si qytetar shqiptar. Kur u pyet nga gazetarët presidenti i delegacionit turk Şükrü Kaya për insistimin e delegacionit shqiptar deklaroi se delegacioni shqiptar insistonte qe kush kishte të drejtë zgjedhjeje do të kishte të drejtë të zgjedhjes që të mos përfshiheshin në shërbimin ushtarak në Turqi.

Arsyeja aq e ndjeshme që qëndronte pas insistimit të delegacionit shqiptar në çështjen e shtetësisë (kombësisë) qëndron se shqiptarëve që jetojnë në Turqi dhe në Stamboll ishin më të arsimuar dhe më të kulturuar dhe në gjendje të mirë ekonomike.

Delegacioni shqiptar priste që shqiptarët e Turqisë duke ruajtur pozitën e tyre aktuale të kontribuonin edhe në Shqipëri. Përveç kësaj, delegacioni shqiptar kishte rezistuar që çdo shqiptar i cili do të përdorë të drejtën e kthimit në Shqipëri, për aq kohë sa ata të mbeten në Turqi të mosrekrutoheshin në ushtri. Ndërsa Turqia e nuk kishte ndërmend të bëjë lëshime për sanksione të tilla pa marrë parasysh se nga vinin.

Delegacioni shqiptar bëri edhe një përpjekje të re. Sipas kësaj, shqiptarëve të cilëve u kishte ardhur mosha për shërbimin ushtarak do të përdornin menjëherë të drejtën për të zgjedhë, ndërsa ata që zgjodhën shtetësinë shqiptare do të ktheheshin menjëherë në Shqipëri.

Ndërsa ata që qëndrojnë në Turqi do të mund të rekrutoheshin. Propozimi i delegacionit shqiptar u pranua pozitivisht nga Ankaraja. Traktatet u nënshkruan në Stamboll më 8 dhjetor 1923 nga delegacioni shqiptar dhe pastaj delegacioni u largua nga Stambolli. Pala turke gjithashtu nënshkroi traktatet më 15 dhjetor 1923.

Traktati i Miqësisë Turqi-Shqipëri

Traktatin e parë të miqësisë Turqia e ka nënshkruar me Poloninë në Lozanë, kurse pas shpalljes së Republikës, traktati i parë i miqësisë u nënshkrua me Shqipërinë. Në mënyrë të ngjashme edhe Shqipëria traktatin e parë të miqësisë e nënshkroi me Turqinë.

Marrëveshja për leje qëndrimi Turqi-Shqipëri

Kjo marrëveshje rregullon kushtet e qëndrimit të shqiptarëve në Turqi dhe turqve në Shqipëri.

Traktati i kombësisë Turqi-Shqipëri

Ata që janë banorë të territorit shqiptar dhe që banojnë në territorin e shtetit shqiptar kur ky traktat hyn në fuqi, do të pranohen në shtetin e Shqipërisë. Kur traktati hyn në fuqi, ata të cilët janë nga shteti shqiptar por banojnë në tokën turke do të mbesin në Turqi. Ata të cilët do kalojnë në shtetësinë e Shqipërisë, brenda një viti pas datës së hyrjes në fuqi të traktatit do të detyrohen që pronat nga asetet në Turqi t'i lirojnë, t'i paguajnë të gjithë borxhin dhe do të largoheshin nga Turqia për të mos u kthyer më.

Si rezultat i bisedimeve midis delegacioneve të Turqisë dhe Shqipërisë me nënshkrimin e traktatit të Miqësisë më 15 dhjetor 1923 si dhe marrëveshjet, për kombësi dhe qëndrim u lidhën marrëdhëniet politike Turqi-Shqipëri nën kornizat ligjore.

Ndikimet e shpalljes së Republikës së Turqisë në Shqipëri

Shqiptarët, si në luftën për pavarësi, po ashtu edhe pas luftës kanë vazhduar të monitorojnë zhvillimet në Turqi. Menjëherë pas nënshkrimit të Traktatit të Lozanës, më 1 gusht 1923, Mahmut Paşazade Akif Pasha i Partisë Kombëtare të Luftës Kombëtare në Elbasan, përgëzoi fitoren

e Lozanës me një telegram të dërguar nga Vjena për Mustafa Kemal Pashën.

Pas luftës për pavarësi vjen themelimi i Republikës Turke mirëpo gjatë kësaj periudhe ende nuk ishte zgjidhur çështja e regjimit në Shqipëri. Kështu të frymëzuarit nga lufta e pavarësisë turke, e kanë shikuar nga këndvështrime të ndryshme ndryshimin e regjimin në Turqi dhe kjo kishte bërë të kishte diskutimet ndryshme intelektuale. Ndërsa grupet republikane dhe monarkistët i referohen lëvizjes revolucionare turke, ata jashtë tyre kritikuan anulimin e sulltanatit dhe shpalljen e Republikës.

MARRËDHËNIET NDËRMJET REPUBLIKËS SE TURQISË DHE REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË NDËRMJET VITEVE 1923-1928

Qeveria parlamentare në fund të Luftës së Parë Botërore u përpoq për të dhënë mbështetje për luftën e tyre për pavarësi kundër pushtimeve imperialiste. Përveç afërsisë së saj historike dhe kulturore edhe Greqia ka një rol të rëndësishëm në afërsinë ndërmjet dy vendeve sepse ajo ishte një pushtues në të dy vendet. Së pari nga Turqia në Shqipëri ne shtator 1920 kishte shkuar kolonel Hamdi Beu një oficer me prejardhje shqiptare. Kolonel Hamdi Beu, menjëherë kishte filluar të punojë me kryeministrin shqiptar Sulejman Fehmi Beu dhe filloi të punojë si komandant i përgjithshëm i ushtrisë shqiptare (shefi i Shtabit të). Më vonë, qeveria shqiptare propozoi kolonel Selahattin Saip Beu për të shërbyer si ministër i mbrojtjes. Selahattin Beu me miratimin nga Mustafa Kemal Pasha, President i Qeverisë Parlamentare e pranoi këtë mision dhe shkoi në Shqipëri në fillim të janarit 1921. Më vonë Selahattin Beu mori mbiemrin Shkoza, në Shqipëri kishte krijuar një ushtri të rregullt dhe kishte vendosur ligjet themelore të ushtrisë. Në këtë periudhë përveç Selahattin dhe Hamdi Beut nga Turqia në Shqipëri kishin ardhur shumë ushtarë dhe punonjës civil me origjinë shqiptare. Selahattin beu si dhe ushtarët, oficerë dhe shërbyesit civil të ardhur nga Turqia e thelluan punën e tyre me ushtrinë shqiptare.

Greqia e cila në të njëjtën kohë ishte pushtuese si në Shqipëri po ashtu edhe në Anadoll u ankua duke i cilësuar oficerët që shkojnë nga Turqia në Shqipëri si "oficerët e Kemalit". Ushtria e rregullt shqiptare e formuar nga Selahattin dhe Hamdi Beu u tregoi aktivitete të suksesshme në vijat kufitare serbe dhe greke, Greqia, ai u detyrua të dërgojë më shumë forca në kufi me Shqipërinë. Në këtë proces, në qoftë se Greqia do të kishte

qenë e suksesshme, pushtimi në të dyja vendet do të bëhej i përhershëm si në Turqi po ashtu edhe në Shqipëri. Mustafa Kemal Pasha, pasi mundi t'i bindë shqiptarët për këto rreziqe, shqiptaret edhe e mbajtën mirë frontin e vet mirëpo kishin përcjell me interes të larte edhe zhvillimet në Anadoll.

Fitorja e luftës në Anadoll nga Inony, u festua në mënyrë entuziaste dhe nga shqiptarët në Shqipëri, dhe filluan të besojnë se Greqia mund të mposhtet edhe në vendin e tyre. Fitorja e Betejës së Sakarjës në vitin 1921 u festua në Shqipëri dhe në botën islame. Si rezultat i disfatës së grekëve në betejën e SakarjaBritania filloi të zbut politikat në Turqi ka qenë i detyruar të ndryshojë planet në Shqipëri, dhe deklaruan se Greqia duhet të tërhiqet nga Shqipëria. Greqia nuk mundi t'i rezistonte këtij vendimi të Anglisë. Kështu, si rezultat i bashkëpunimit midis Asamblesë së Madhe Turke dhe Shqipërisë, okupimi grek nuk mundi të bëhej i përhershëm në të dyja vendet.

Traktati i Lozanës 1923 dhe shqiptarët

Si rezultat i Luftës për Pavarësinë e Turqisë, u mbajt më 20 nëntor të vitit 1922 Konferenca e Lozanës. Fillimisht u vendos që Shqipëria, e cila nuk ishte e ftuar në Konferencën e Lozanës, do të bashkohej me komisionet e borxheve të shtetit osman. Me pjesëmarrjen e Shqipërisë në këto sesione, delegacioni i Asamblesë së Madhe Turke dhe delegacioni i Qeverisë shqiptare u takuan për herë të parë në një takim ndërkombëtar.

Kuadri ligjor i marrëdhënieve politike mes dy vendeve u përcaktua, me marrëveshjen e nënshkruar më 15 dhjetor 1923, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Shqipërisë. Por këto traktate, nuk kanë hyrë në fuqi pasi nuk u miratuan në parlamentet e të dy vendeve dhe marrëdhëniet politike Turqi-Shqipëri dështuan për të filluar. Shqipëria, që e kishte fituar pavarësinë e saj, nuk mundi të arrinte stabilitetin e saj të brendshëm, as të zgjidhë regjimin e saj. Pasi Ahmet Zogu u kthye në Shqipëri më 13 dhjetor 1924 dhe mori pushtetin me një grusht shteti, parlamenti shqiptar shpalli Republikën më 21 janar 1925. Si rezultat i zgjedhjeve të mbajtura më 31 janar 1925, Ahmet Zogu u zgjodh president për 7 vjet. Megjithatë, Ahmet Zogu, i cili mori pushtetin në duart e veta, krijoi një administratë të afërt me administratën e mbretërisë.

Në periudhën pas zgjedhjes së Presidentit Ahmet Zogu, në Shqipëri stabiliteti i brendshëm u arrit dhe qeveria ishte në gjendje të kthehej në politikën e jashtme të vendit. Si rezultat Ministria e Jashtme shqiptare, i deklaroi Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë se do të aprovohej traktati i arritur midis Turqisë dhe Shqipërisë më 15 dhjetor 1923 dhe kështu para vënies së raporteve zyrtare ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë nuk kishte asnjë pengesë.

Pas miratimit të marrëveshjeve reciproke të nënshkruara ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë, sipas nenit të dytë të traktatit të miqësisë së dy vendeve në mënyrë reciproke u vunë në veprim për të hapur konsullata dhe ambasadat. Në këtë kontekst, Republika e Turqisë, 24 korrik 1925 në port qytetin e Vlorës të Shqipërisë ka hapur një konsullatë turke, e cila do t'i organizojë më shumë marrëdhëniet tregtare. Apdülahat Bey (Akşin) u caktua si Konsull në Vlorë me dekretin e 19 qershorit 1926. Menjëherë pas hapjes së konsullatës në Vlorë është hapur ambasada në Tiranë dhe Tahir Lutfi beu u emërua si ambasadori i parë i Turqisë në Shqipëri.

Hapja e Ambasadës Turke në Tiranë dhe përfaqësimi i Turqisë, u prit shumë pozitivisht si nga populli po ashtu edhe në qeverinë shqiptare. Në veçanti, populli shqiptar ishte prekur nga këto zhvillime dhe ditën e ceremonisë pjesa e përparme e rezidencës presidenciale u rrethua nga një turmë e madhe njerëzish të cilët ishin duke pritur betimin e ambasadorit turk dhe e përshëndetën delegacionin e Turqisë.

Ambasadori i parë i Republikës së Shqipërisë në Turqi, ishte Rauf Fitso, i cili pas diplomimit ne administratën publike kishte bërë praktikë gjatë viteve 1903-1906 në Janinë dhe kishte marrë titullin prefekt. Pasi kishte qenë i emëruar prefekt në Konicë (1906), Himarë (1909), Çamëri(1909) dhe Kızılcahamam (1910) ishte bërë guvernator i Kayserit. Rauf Fico u kthye në Shqipëri pas Luftërave Ballkanike dhe mori postin e nënsekretarit të Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë. Ambasadori i parë në Turqisë nga Republika e Shqipërisë, ishte Rauf Beu, më 14 shkurt 1926 ai erdhi në Stamboll dhe pas disa ditësh mbërriti në Ankara.

Konventa konsullore ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë (1927)

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë, ishin zhvilluar në një mënyrë miqësore dhe të dy vendet,

vendosën të nënshkruajnë Konventën konsullore, e cila përcakton miratimin e konsujve të ndërsjellë në vendet e tyre dhe përcakton ligjin, privilegjet, përjashtimet dhe kompetencat e konsujve dhe përfaqësuesit të tyre. Konventa, u nënshkrua në Tiranë më 11 korrik 1927 nga Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë Tahir Lutfiu dhe nga Ministri i Jashtëm shqiptar Iljas Bej Vrioni.

Në atë periudhë qeveria shqiptare ishte vonë për të konfirmuar këtë marrëveshje. Pastaj marrëdhëniet Turqi-Shqipëri pasi u deklarua mbretëria në Shqipëri më 1 shtator 1928 ishin ndërprerë. Megjithatë, pas vitit 1931, pas normalizimit të marrëdhënieve, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë autorizoi Ministrinë e Punëve të Jashtme që të miratojë traktatin me vendimin e 14 majit 1932 dhe Konventa konsullore, e cila u përcaktua në kornizat ligjore në vitin 1927, mundi të hyjë në fuqi pesë vjet më vonë.

Aneksimi i Shqipërisë nga Italia reflektimi i kësaj situate në marrëdhëniet Turqi-Shqipëri

Turqia, kishte deklaruar mbështetjen dhe inkurajimin e saj ndaj politikës shqiptare, përpjekjet për reformat në jetën shoqërore dhe pavarësinë e saj. Shqipëria që konsiderohej si një vëlla nga Turqia, gjatë progresit të zbatimit të reformave të tyre, Turqia ndoqi nga afër përpjekjet e presidentit shqiptar për reforma. Presidenti Ahmet Zogu i Shqipërisë, në të njëjtën periudhë ishte përpjekur ta zhvillojë si nga brenda dhe jashtë vendin e tij dhe ta ngrejë në nivelin e vendeve të zhvilluara të tilla si Turqia. Presidenti Ahmet Zogu, si dhe populli shqiptar për kontributin në një luftë të ngjashme, në çdo rast kishin shprehur ndjenja dashurie dhe respekti si përTurqinë ashtu edhe për presidentin e saj Mustafa Kemalin. Si rezultat i kësaj, presidenti i Shqipërisë Ahmet Zogu, për të ruajtur afërsinë me Turqinë kishte treguar përpjekje të veçantë.

Më 29 korrik 1926, Presidenti shqiptar u takua me ambasadorin e Tiranës Tahir Lütfi Beu për të diskutuar se si kundërshtarët e regjimit shqiptar në Itali kanë marrë përsipër një rebelim për rrëzimin e qeverisë shqiptare dhe më pas në pushtet do ta sillnin ish princin e atëhershëm osman Omer Faruk (biri i Halifit të fundit Abdulmexhid Efendi). Sipas Zogut ish-princi, kishte shkuar në Brindizi dhe Bari për të takuar opozitën. Ahmet Zogu gjithashtu e informoi rreth masave që qeveria shqiptare do të merrte kundër tyre.

Turqia në këtë periudhë u përpoq të vazhdojë të mbështesë këtë vend pa ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë. Një telegram shifër ka ardhur nga ambasada e Turqisë në Athinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në lidhje me kundërshtarët e regjimit shqiptar Shqipërisë në Selanik. Ky telegram përmbante informacionin e koduar se kjo ishte pjesë e një revolucioni ne bashkëpunimme Jugosllavinë. Kundërshtarët e pushtetit shqiptar ishin te ndare në dy grupe kur njëri grup pretendonte qe të fillonin me vrasjen e Ahmet Zogut dhe krejt këtë periudhë ta përfundonin brenda katër deri në pesë javë. Me vendim të Kryeministrit Ismet Pasha, më 9 gusht 1927 ky informacion i dorëzohet Qeverisë së Shqipërisë që e kishte mbajtur të informuar me zhvillimet Ahmet Zogun.

Turqia mbështeti edhe trajnimin e oficerëve të aviacionit të Shqipërisë. Shkolla e Aviacionit në Eskisehir do të mundësonte trajnimin e 10 oficerëve shqiptar, gjithashtu shpenzimet e fluturimit si dhe demet e mundshme gjatë trajnimit me vendim të Këshillit të Ministrave janë pajtuar që duhet të paguhet nga Republika e Turqisë me idenë se do të konsolidojë edhe me tej marrëdhëniet miqësore midis Turqisë dhe Shqipërisë.

Ndërkohë që Turqia ishte duke u përpjekur për të bërë zhvillim me burimet e veta, për fat të keq Shqipëria, filloi të ndjekë politika të ndryshme duke bërë kërkimin e mbështetjes së jashtme. Disa intelektualë dhe politikanë shqiptarë kishin treguar mungesën e burimeve ekonomike të vendit si rezultat i këtyre politikave të gabuara.

Edhe pse marrëdhëniet politike ndërmjet turqve dhe shqiptarëve kishin filluar, marrëdhëniet tregtare, të cilat do t'i bëjnë këto marrëdhënie të përhershme, nuk kishin filluar. Qeveria shqiptare, në marrëdhëniet politike me Turqinë ishte treguar e nxituar për të zgjidhur problemet e shqiptarëve në Turqi, ndërsa në marrëdhëniet tregtare të saj përparësi i dha Italisë. Qeveria e Shqipërisë, për të filluar marrëdhëniet politike me Turqinë kishte dërguar një delegacion mirëpo njëkohësisht kishte dërguar një delegacion tjetër edhe në Itali për të zhvilluar marrëdhëniet tregtare. Kjo e ka bërë Shqipërinë të varur nga fuqitë e huaja në fazat e para të pavarësisë së saj. Kjo varësi është bërë e vazhdueshme me traktatet me Italinë. Italia fitoi statusin më të preferuar të vendit në Shqipëri.

Shqipëria dhe Turqia pas nënshkrimit të tre traktateve më 15 dhjetor 1923, në rendin e ditës së dy vendeve ka qenë vendosja e marrëdhënieve tregtare ndërmjet tyre. Pavarësisht traktatit të nënshkruar me Italinë më

15 mars 1925, Ministria e Jashtme turke vendosi që do të ishte e dobishme për të bërë marrëveshje tregtare me Shqipërinë, duke pasur parasysh se do të kontribuonte në marrëdhëniet politike. Për këtë qëllim, përpara nënshkrimit të një marrëveshjeje tregtare me Shqipërinë, Konsullata e Republikës në Vlorë përgatiti një raport të gjerë mbi situatën ekonomike të Shqipërisë. Struktura ekonomike e Shqipërisë në raportin për vitet 1921-1924 dhe marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera, veçanërisht me Turqinë u trajtuan në detaje. Informacioni në këtë raport kishte për qëllim për t'i dhënë drejtim traktatit që do të bëhej me Shqipërinë.

Politika e Shqipërisë ndaj Turqisë nuk kishte prioritet për zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike. Arsyeja për këtë iniciativë mund të jetë edhe zhvillimi në kushte të ngjashme ekonomike të Turqisë dhe Shqipëria ka menduar se nuk do të mund të sigurojë kredi nga Turqia. Si rezultat, Shqipëria pasi siguroi pavarësinë e saj, Turqia më vonë i dha prioritet për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve të mbetur në Turqi. Në këtë periudhë të historisë Shqipëria deklaroi se do të bëjë marrëveshje tregtare me Turqinë dhe u vu përballë kërkesës së Turqisë për traktatin e tregtisë, por traktatin nuk e nënshkroi.

Si rezultat, Shqipëria, në vend të bënte traktat me Turqinë në këtë periudhë ka bërë një marrëveshje që lejon lehtësime për Italinë dhe kjo bëri që një marrëveshje tregtare me një vend tjetër të pengohej.

E pakënaqur me privilegjet ekonomike, Italia u zhvendos për të marrë një nismë ekonomike dhe politike ndaj Shqipërisë një hap më tej dhe veproi për të ndërhyrë plotësisht në Shqipëri. Shqipëria ishte e detyruar të nënshkruante Paketën e Miqësisë dhe Sigurisë me Italinë më 27 nëntor të vitit 1926 në Tiranë. Ky pakt nënkuptonte se Shqipëria ishte nën ndikimin italian politikisht dhe ekonomikisht. Traktati i Tiranës ngriti shqetësime rreth integritetit territorial të Shqipërisë në publikun turk. Ndërsa nënshkrimi i Paktit të Tiranës u diskutua në shtypin turk, privilegji i Italisë në Shqipëri filloi të bëhet një frymë dominuese, duke kërcënuar paqen e Ballkanit.

Shpallja e Mbretërisë së Shqipërisë dhe reflektimi mbi marrëdhëniet më Turqinë

Ahmet Zogu, pasi u bë president në vitin 1925 mbretëria ishte gjithmonë në agjendë. Në vitin 1926, ambasadori italian Aloiz Baron i propozoi

Zogut të martohej me ndonjë vajzë nga familja mbretërore italiane dhe të bëhej mbret i Shqipërisë, por Zogu nuk e kishte pranuar atë. Thashethemet se Ahmet Zogu do të bëhet mbret po ashtu u botuan në shtypin turk. Traktati i Aleancës, i cili u bë me Italinë më 22 nëntor të vitit 1927, e shtoi më tej parashikimin e mbretërisë në Shqipëri.

Që nga Italia dhe Ballkani, madje edhe disa shtete evropiane, u qeverisën nga regjimi i monarkisë kështu që, bota e jashtme ishte e përshtatshme për mbretërinë. Me kalimin e kohës, Zogu, i cili mori më shumë mbështetje nga Italia, e bëri mjedisin e brendshëm të vendit të gatshëm për ndryshimin e regjimit, ndërsa ai mblodhi pushtetin në duart e tij dhe e shtypi opozitën. Më 20 gusht 1928, populli i Tiranës dhe rajonit përreth organizuan një tubim të madh dhe kërkuan që kurora e shtetit shqiptar t'i jepej Ahmet Zogut për të qenë mirënjohës për shërbimet e tij në vend. Ahmet Zogu u shpall shpëtimtar i vendit dhe njerëzit përshëndetën Zogun me pankarta me mbishkrimet president dhe mbret. Gjithashtu kishin filluar të dërgohen për Ahmet Zogu që të bëhej mbret. Si rezultat, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj në parlament më 30 gusht 1928 për të ndryshuar regjimin dhe deklaroi Ahmet Zogu si "Mbreti i Shqiptarëve" më 1 shtator 1928.

Më 1 shtator 1928 Ambasada Turke në Londër deklaroi duke u bazuar në telegrafin e agjencisë "Central News" në Stamboll dhe në disa gazeta se është përhapur lajmi se Presidenti i Turqisë, Mustafa Kemal gjithashtu do të bëhej mbret. Ky fakt, i cili nuk pasqyron të vërtetën, është hedhur poshtë dhe me udhëzimet nga Ankaraja ambasada e Londrës kishte botuar këtë deklaratë në kopjet e gazetave "Reuter Agency" dhe "Times", "DailyTelegraph" dhe "Manchester Guardian" më 7 shtator 1928.

Monarkia Zog nuk njihet nga qeveria turke. Arsyeja ishte se të kaluarit e Republikës se Shqipërisë në monarki është një mundësi inkurajuese edhe për kundërshtarët e regjimit republikan në Turqi. Të paraqiturit e Mbretit Ahmet Zogu nga shtypi pro-britaniksi shembull për Mustafa Kemalin në njërën anë i përkëdhelte egot e shqiptarëve pro monarkisë në anën tjetër zemëroi turqit dhe presidentin e Republikës se Turqisë.

Ministri i jashtëm turk, e thirri ambasadorin e Tiranës Tahir Lutfi Beu, më datë 3 tetor 1928 i kërkoi të shkonte në Ankara. Ambasadorin turk e zhvendosi Fuat Beu dhe më 7 tetor u largua për në Ankara për të mos u kthyer më. Gazi Mustafa Kemal, në një intervistë me gazetën franceze "Petit Parisien" të datës 8 tetor 1928 deklaroi "... *kjo të pranohet? Jo, jo,*

nuk do ta njoh kurrë mbretin, ndoshta mbarë bota do ta konfirmojë atë. Pa marrë parasysh se çfarë, nuk do ta njoh mbretërinë e këtij njeriu". Ministri i Jashtëm shqiptar duke e ftuar Fuad Beu në ministri më 20 tetor 1928, ne lidhje me mbretin e Shqipërisë ai shprehu pakënaqësinë e tij me përdorimin e fjalëve të rënda si "ky njeri". Po ashtu ministri i kërkoi që Republika e Turqisë ta njoh mbretërinë mirëpo po ashtu theksoi se është e parëndësishme për ta nëse nuk e pranojnë. Ai kërkoi gjithashtu që qeveria turke të dërgojë një shpjegim për shtypin turk se kjo deklaratë nuk erdhi nga burime zyrtare. Por deklarata e pritur nga Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë nuk erdhi dhe, Mustafa Kemal Pasha vazhdoi me qëndrim të vendosur për këtë çështje.

Mustafa Kemal Pasha mendonte se populli, parlamenti, qeveria dhe edhemiku më i afërt i Zogut nëse do të i ofronte mbretërinë nuk do të duhet të pranojë mbretërinë dhe t'i rezistonte këtyre presioneve. Kjo i përkeqësoi gjerat dhe krijoi zhgënjim në Tiranë. Shqiptarët shpresonin se një qortim do të lëshohej ashtu siç ata kërkuan dhe se ambasada do të kthehej. Megjithatë, meqë i dërguari nuk u kthye, Gazi Mustafa Kemal dhe mediat turke vazhduan kritikat e tyre kundër Ahmet Zogut. Pastaj Shqipëria nuk u vonua për t'u përgjigjur dhe qeveria shqiptare e mbylli ambasadën e saj në Ankara si reagim të parë.

Konsullata shqiptare në Stamboll u mbyll në vitin 1930 dhe të gjithë punonjësit u detyruan të ktheheshin se bashku me Konsullin e Stambollit Z. Nezirin. Më vonë, Shqipëria caktoi Asaf Beun, i cili shërbeu si i ngarkuari me punë në Ankara për konsullatën italiane në Stamboll. Mbretëria e Shqipërisë, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shqiptarëve në Turqi në këtë mënyrë e zgjodhi t'i besojë shtetit italian. Në të njëjtën periudhë, marrëdhëniet zyrtare midis Shqipërisë dhe Turqisë nuk u ndërprenë plotësisht edhe pse tërhoqi ambasadorin e saj, Turqia përsëri ambasadën e mbajti të hapur në nivel të ngarkuarish me punë.

Në procesin e ardhshëm, mosnjohja e mbretit nga Turqia ka shkaktuar reagime të ndryshme në Shqipëri në radhët e monarkistëve dhe republikanëve. Një nga tregtarët shqiptarë kishte marrë veshjet të ndryshme të Gazi Mustafa Kemal Pasha nga Stambollit si dhe kishte shtypur disa postera me komandantet turk po ashtu edhe fotografi me stemën e Izmir Kuva-yi shenja të tjera që tregojnë çlirimin dhe shpëtimin filloi t'i shfaq në vitrinën dyqanit të tij. Një gazetar duke pa një blerje të madhe nga shqiptarët, kishte kritikuar këto fotografi ku sipas tij ishin të huaja për historinë dhe kombësinë shqiptare. Pas

kësaj me një urdhër të botuar në gazetën e Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë deklaroi se fotografit e tilla nga dyqanet, kafene dhe vende të tjera publike u konfiskuan. Gjithashtu, që nga data 11 shtator 1928, hyrja e gazetave turke në Shqipëri ishte gjithashtu e ndaluar nga parlamenti. Reaksionet ndaj Turqisë dhe Mustafa Kemal Pashës në Shqipëri nuk mbetën me kaq.

Libri me fjalimet historike të mbajtura nga Presidenti i Republikës se Turqisë, Mustafa Kemal Pasha, në vitin 1927 ishte përkthyer dhe botuar në gazetën "Shekulli i Ri" në Durrës dhe kishte filluar të publikohej në ditët e fundit të 1928, njerëzit kishin pas një interes të madh dhe gazeta kishte rritur ndjeshëm shitjet e saj në disa ditë . Qeveria shqiptare ka ndaluar publikimin e vazhdimit të këtij shkrimi për arsye se ishin ndjerë të shqetësuar.

Shtypni pro-monarkisë në Shqipëri kishte kritikuar Mustafa Kemalin për mos njohjen e mbretit dhe monarkisë. Kundërshtarët e mbretit dhe monarkisë shqiptare, kishin filluar të bëjnë propagandë ata janë të mbështetur nga Turqia dhe Mustafa Kemali të cilët kishin mbështetur mosnjohjen e mbretit shqiptar. Interesi i popullit dhe intelektualëve pro-republikanë shqiptarë ndaj Mustafa Kemalit ishte rritur.

Mbreti Zog për të rregulluar marrëdhëniet Turqi-Shqipëri, i kërkoi ndihmë ministrit tëjashtëm të Italisë. Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike mes Turqisë dhe Shqipërisë, e kishin shqetësuar Romën së bashku me Tiranën, Musolini në Romë priti ne vizitë ministrin e jashtëm Turk Teuvfık Rüştü dhe i kërkoi ta njohë mbretërinë e Shqipërisë. Megjithatë të gjitha përpjekjet e diplomacisë italiane dhe të gjitha përpjekjet e Musolinit që Turqia ta njohë Zogun, në sajë të qëndrimit të vendosur të Mustafa Kemalit, kishin dështuar.

Ndërprerja e Marrëdhënieve Politike Turqi – Shqipëri

Pasi Turqia marrëdhëniet me Shqipërinë i uli në nivelin e të ngarkuarit me punë, udhëheqësit e shtetit shqiptarë i zhveshën nga marrëdhëniet diplomatike të ngarkuarit me punë emisarët e Turqisë. Kjo sjellje ishte intensifikuar aq shumë sa që të ngarkuarit me punë, diplomatët dhe punonjësit civilë që punonin në ambasadën e Turqisë në Tiranë, gjithmonë trajtoheshin me keq se sa diplomatët e vendeve të tjera dhe qeveria shqiptare nuk i ftoi më në asnjë manifestim zyrtar. Udhëheqësit

e shtetit shqiptar me ndihmën edhe të Italisë u munduan ta mbyllin ambasadën Turke.

Qeveria shqiptare në mënyrë të mefshtë publikoi në gazetën "Besa" shkrime fyese dhe ofenduese ndaj Turqisë. Pasi mori lajmin se një grup njerëzish do të protestonin para të ngarkuarit me punë në Tiranë në Ambasadën Turqisë me sloganet "Ne nuk duam ambasadorin e një shteti që nuk e njeh mbretin tonë". Menjëherë e lajmëroi këtë rast në Ankara dhe Ministria turke e Punëve të Jashtme, dhe i dha direktiva të Ngarkuari me Punë të mos ketë asnjë kontakt zyrtar me qeverinë shqiptare në Tiranë, dhe në asnjë mënyrë të mos iu përgjigjen këtyre protestave dhe sloganeve.

Megjithëse shqiptarët nuk ndërprenë marrëdhëniet zyrtare me Komisionerin e Lartë të Turqisë, ata nuk kishin takime të tjera diplomatike dhe nuk u ftuan në asnjë vend dhe kështu ata mbeten në Tiranë pikërisht si vëzhgues.

Përkundër nxitjeve të Shqipërisë dhe Italisë, Mustafa Kemal Pasha dhe qeveria turke, me ambasadën e mbajtur në Tiranë, patën mundësinë të vlerësojnë drejtpërdrejt zhvillimet në Shqipëri me vëzhgimet e stafit të tyre të ambasadës. Shkaku tjetër i mbajtjes hapur të Ambasadës se Turqisë në Tiranë është edhe shpresa qe Shqipëria t'i bashkohej bashkësisë së Ballkanit, që do të krijohej në të ardhmen.

Turqia dhe Shqipëria në Konferencën e Ballkanit

Që nga fillimi, Mustafa Kemal ka dashur që vendet e Ballkanit të mbijetojnë si shtete kombëtare dhe të jenë të pavarur me të gjitha të drejtat e tyre, dhe të liruara nga lojërat e shteteve imperialiste. Si rezultat ai besonte se vendet e Ballkanit, të cilat kanë jetuar dhe bashkëjetuan prej shekujsh, duhet të kenë një aleancë të fortë dhe madje unitet. Mustafa Kemali, nga njëra anë, u përpoq të parandalonte grindjet e vendeve të Ballkanit mes tyre, por nga ana tjetër ai bëri një përpjekje për të bashkuar kombet dhe popujt e Ballkanit.

Ishte gjithashtu efektive që ndikimi ekonomik dhe politik i Italisë mbi Shqipërinë dhe zgjerimi i politikës së Musolinit duke përdorur koncepte si "Italia e Madhe, deti ynë, Mesdheu" në ardhjen e aleancave ballkanike drejt viteve 1930. Ndërsa Italia fillon të ndjekë një politikë ri-ekspansioniste dhe agresive në Mesdhe si dhe përpjekja e Turqisë,

dhe Greqisë që t'i zgjidhin problemin e shkëmbimeve të popullsisë dhe mosmarrëveshjet e tjera midis tyre bëri që të mblidhen konferencat e Ballkanit.

Në periudhën kur Konferenca Ballkanike dhe aleanca e saj ishin në rend dite, asistenca vjetore financiare e Italisë për Shqipërinë ka qenë e pamjaftueshme. Përveç kësaj, nacionalizmi shqiptar nisi një rezistencë kundër kolonializmit italian duke dhënë reagimin e pritur, Organizata e shqiptarëve të Rinj dhe Partia Bashkimi Kombëtar kanë sjellë një kundërshtim të fortë kundër Italisë. Mbreti Zog, i cili e përceptoi gabimin e politikës Italiane, filloi t'i përcjellë të gjitha nismat kundër Italisë si brenda vendit ashtu edhe jashtë duke filluar nga Turqia dhe në gjithë Ballkanin, dhe filloi të rezistojë, të rinovojë Paktin pesëvjeçar në Tiranë të cilit data e skadimit iu ishte afruar. Si rezultat, Shqipëria vendosi të marrë pjesë në Konferencën Ballkanike.

a- Turqia dhe Shqipëria në Konferencën e Parë Ballkanike

Konferenca e Parë Ballkanike u mbajt në Athinë nga 5 deri në 12 tetor në vitin 1930 dhe konferencës iu bashkuan Turqia, Bullgaria, Shqipëria, Jugosllavia dhe Rumania.

Konferenca Ballkanike u mblodh në një kohë kur Mbret i Shqipërisë Zogu dhe paria e vendit bënin përpjekje për ta shpëtuar vendin nga ndikimi fashist Italian, dhe pakti i Tiranës ishte afër të përfundoi. Për këtë arsye, mbreti Zog e pa këtë Konferencë si një mundësi për të konsoliduar pavarësinë e tij politike dhe për t'iu shpjeguar vendeve të tjera për trajtimin e keq që shqiptarët në Greqi dhe Jugosllavi po përballen. Delegacioni shqiptar pretendonte se numri i shqiptarëve jashtë kufijve kombëtarë shqiptarë ishte po aq sa në territorin e Shqipërisë, në Konferencë, ajo së bashku me Bullgarinë solli çështjen e pakicave në rendin e ditës, dhe u akuzua se kishte vepruar së bashku me Bullgarinë në lidhje me këtë temë.

Delegacionet e Shqipërisë dhe Jugosllavisë vazhdimisht gjatë konferencës debatuan si për shkak të marrëdhënieve të Shqipërisë me Italinë, po ashtu edhe për çështjen e minoriteteve. Sipas delegacionit shqiptar Turqia ka qenë një faktor kryesor që shpëtoi shqiptarët nga të qëndruarit në mes dy zjarreve. Këto deklarata nga delegacioni shqiptar

janë shumë të rëndësishme. Ky zhvillim mund të shihet si një rifillim të marrëdhënieve Turqi-Shqipëri për një fazë të mëvonshme.

b- Turqia dhe Shqipëria në Konferencën e Dytë Ballkanike

Në Shqipëri, kishte një debat të gjerë nëse delegacioni shqiptar duhej të merrte pjesë në Konferencën e Dytë Ballkanike në Stamboll, apo jo. Grupi kundërshtar kishte pyetur delegacionin shqiptar me në krye Mehmet Konicën a duhej të merrte pjesë në një konferencë në një vend i cili nuk e njeh Shqipërinë dhe ende e konsideronte territor të shtetit të saj. Sipas grupeve opozitare ishte e pa kuptimtë pjesëmarrja e Shqipërisë për arsye se Konferenca e Parë Ballkanike, nuk e zgjodhi problemin e një milion shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Por Mbretit Zog nuk ishte i të njëjtës ide ku sipas ti kjo konferencë mund të shërbente në përmirësimin e marrëdhënieve Turqi-Shqipëri dhe i dha udhëzime që së bashku me delegacionin turk të përpiqeshin në ndreqjen e marrëdhënieve në Konferencën e Ballkanit në Stamboll. Mbreti Zog, shpresonte se do të përmirësoheshin marrëdhëniet dhe në qoftë se do të ndjehet mundësia e njohjes së monarkisë i dha instruksione delegacionit shqiptar të shkojë në Ankara, përndryshe do të duhej të ktheheshin në vend.

Konferenca e Dytë Ballkanike u mblodh më 20 tetor 1931 në Stamboll me pjesëmarrjen e gjashtë shteteve të Ballkanit. Delegacioni shqiptar vazhdoi të mbajë në rendin e ditës çështjen e pakicave. Delegacioni jugosllav po ashtu akuzoi Shqipërinë për përpjekjen për të penguar bashkimin ballkanik me mbështetjen e Italisë. Delegacioni shqiptar, në njërën anë përçoi mesazhe të ngrohta për Turqinë në Konferencën Ballkanike. Njëri nga ideuesit dhe mbrojtësit e idesë së bashkimit ballkanik Mustafa Kemal Pasha, mendonte se duhet të ketë unitet të të gjitha shteteve të Ballkanit. Mungesa e një marrëdhënie të drejtpërdrejtë vetëm me mbretin shqiptar në mesin e udhëheqësve shtetëror të Ballkanit, ku këtë e kishte konsideruar si një pengesë para bashkimit ballkanik dhe për ta larguar këtë pengesë Konferencën e Ballkanit në Turqi, e shihte si një mundësi edhe për korrigjimin marrëdhënieve Turqi-Shqipëri. Sipas Mustafa Kemal Pashës bashkimi ballkanik ishte një ideal për të gjitha çështjet dhe kjo ishte një objektiv që duhet të arrihet. Edhe mbretit të Shqipërisë, ai mendonte se e kishte tradhtuar popullin e tij duke pranuar që të jetë mbret, duke mos e ndarë nga kokat e tjera ballkanike iu dërgoi telegram për të arritur këtë qëllim.

Në telegramin e dërguar nga Mustafa Kemal te Mbreti Zog, qeveria Zogut ishte shumë e kënaqur që Zogu cilësohej si një "mbret" dhe qeveria shqiptare e konsideroi këtë si njohje të plotë të Mbretit Zog. Shtypi shqiptar gjithashtu filloi t'i bëjnë presion qeverisë të rihapë ambasadën në Turqi. Ndërkohë, Britania e kishte kritikuar Mustafa Kemalin që në fillim për mos njohjen e regjimit të mbretërisë në Shqipëri dhe madje pretendoi se Mustafa Kemali do të bëhej mbret. Pas telegramit të Mustafa Kemal Pashës u pa një interesim i shtuar për përfaqësuesin e Turqisë në Tiranë si nga Mbreti i Shqipërisë po ashtu edhe nga drejtuesit tjerë. Emisari turk, i cili nuk u pranua kudo për shkak të mosnjohjes zyrtare të mbretërisë dhe pothuajse i burgosur në ndërtesën e ambasadës, filloi të pranohej në nivelin më të lartë pas telegrameve të ndërsjellë.

PERIUDHA E DYTË E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË TURQISË – MBRETËRISË SË SHQIPËRISË (1931-1938)

Rivendosja e marrëdhënieve politike

Ministri i Jashtëm shqiptar Xhafer Villa, duke ftuar në ministrinë Emisarin e Turqisë në Tiranë i paraqiti qëllimin e mbretit Zog se i ngarkuari me punë në Konsullatën e Përgjithshme në Shkup Xhavit Leskovikun për ta deleguar si delegat fuqiplotë në Turqi,dhe ne cilësinë e ambasadorit. Rrjedhimisht, Xhavit Leskoviku i cili duke studiuar në Turqi kishte shërbyer në Ushtrinë Turke, ishte emëruar si ambasador. Më 14 Maj 1933 Ambasadori i Shqipërisë Xhavit Beu, ia paraqiti letrat kredenciale Presidentit të Turqisë, Mustafa Kemal Pashës. Rreth një vit pasi Xhavit Beu filloi mandatin e tij, Mustafa Kemal caktoi Sekretarin e Përgjithshëm të Presidencës Rushen Eshref Beu si ambasador në Tiranë për të treguar interesimin e tij mbi Shqipërinë e mbetur jashtë Paktit Ballkanik dhe mundësinë për ta përfshirë këtë vend në Paktin Ballkanik.

Mustafa Kemal, i cili siguroi se Pakti Ballkanik do t'i mbronte kufijtë e Shqipërisë, edhe nëse Shqipëria nuk hynë në pakt, kështu dha mesazhin se marrëdhëniet do të vazhdonin edhe nëse Shqipëria nuk do të hynte në pakt. Me 18 prill 1934, Mbreti i Shqipërisë Zogu, priti në pallatin e tij, Ambasadorin e Turqisë në Tiranë Rushen Eshref dhe

kështu pas shpalljes së mbretërisë për herë të parë Mbreti Zog priti një ambasador turk.

Marrëdhëniet politike mes Ankarasë dhe Tiranës, dukej se ishin në rrjedhën normale, në 1934. Qeveria Shqiptare duke përmendur buxhetin si arsye ka vendosur të mbyllë ambasadën e saj në Turqi. Në bazë të këtij vendimi punët e ambasadës së Ankarasë, do të kryheshin nga ambasada shqiptare në Athinë. Ambasadori turk, duke e raportuar këtë rast për Ankaranë theksoi se Qeveria Shqiptare ka vendosur për hapje te ambasadave të reja në Gjermani, Austri, Çekosllovaki dhe Lituania dhe kjo më tepër duket si shkak se shqiptaret dëshirojnë te dalin nga Pakti Ballkanik se sa për shkaqe buxhetore. Shqipëria, së bashku me ambasadën e Ankarasë e mbylli edhe ambasadën në Sofje, për të njëjtat arsye dhe ambasadori shqiptar i Athinës do të ishte përgjegjës edhe për Republikën e Turqisë, kurse ambasadori në Beograd për Mbretërinë Bullgare. Mbyllja eAmbasadës së Shqipërisë në Ankara për arsye buxhetore u mirëkuptua nga Turqia.

Shqipëria dhe shtetet ballkanike që afrohen me BE-në do t'i afrohen edhe Turqisë. Që në fillim Turqia ka qenë prej mbrojtësve më të mëdhenjë të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO kishte rol të rëndësishëm. Duhet të mos harrojmë se për tërë Ballkanin raportet e ngushta politike dhe ekonomike me Turqinë janë të mundura edhe përmes anëtarësimit në NATO dhe BE.

Në anën tjetër dua të them se BE për shkak të krizave të brendshme politike, s'i jep rëndësi sa duhet Ballkanit e sidomos Shqipërisë. Dua të them gjithashtu se Bashkimi Evropian nuk ka strategji të vërtetë për zgjerim në Ballkan. Ky union ballafaqohet me probleme shumë serioze të brendshme politike dhe ekonomike. Kurse duket qartë se kanë mjaft vështirësi në tejkalim të krizave të lartëtheksuara. Lëvizjet radikale politike e kanë futur politikën evropiane nën kontroll. Kriza ekonomike e vështirëson edhe më shumë këtë situatë, dhe atë në tërë Ballkanin. Partitë qendrore të vjetra evropiane, kanë vështirësi në ndaljen e lëvizjeve djathtiste radikale. Radikalizmi i djathtë në Evropë zhvillohet përmes kundërshtimit të Islamit dhe Bashkimit Evropian dhe si i tillë gjen taban politik. Sot nëse doni shikojeni Francën, Italinë, Gjermaninë, Austrinë, Belgjikën apo Holandën, dhe shihni sa të dobët politikisht janë politikanët që bazohen në zhvillimin e BE-së dhe që e mbrojnë sinqerisht zgjerimin drejt Ballkanit. Fatkeqësisht kjo situatë i ndikon negativisht edhe raportet e BE-së me Turqinë. I brengosur dua të them se shtetet që janë pjesë e Ballkanit nuk duket aq e mundur që në një të ardhme të afërt të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Arsyeja e kësaj assesi s'janë raportet që zhvillohen dhe fuqizohen me Turqinë. Fatkeqësisht kjo përdoret për ta mbuluar një të vërtetë të kthjellët dhe për të mbajtur qëndrim ndaj raporteve në zhvillim me Turqinë. Zhvillimet politike në BE, nuk i hapin Ballkanit perspektivë të tillë. Përkundrazi zhvillimet botërore e orientojnë ekonominë ndërkombëtare drejt një krize. Rendi i tregtisë botërore është duke u tronditur. Evropa dhe SHBA-të nuk ia dalin të punojnë në përputhmëri me njëra- tjetrën. Konkurenca SHBA-Kinë dhe SHBA-Rusi, rritet në mënyrë të rrezikshme. Derisa në politikën globale destabiliteti është në rritje e sipër, as stabiliteti politik në Ballkan s'mund të shihet dhe të analizohet si i garantuar dhe i vazhdueshëm. E the me keqardhje dhe duke u frikësuar se në Ballkan asnjëherë s'janë evituar përplasjet e bazuara në identitet dhe dallime historike. Politika Ballkanike është përplot me vullkane që janë të gatshme të shpërthejnë. Padyshim se edhe Ballkani do të ndikohet nga përplasjet e brendshme të BE-së. Dua ta përsëris se stabiliteti në politikën ballkanike nuk është i garantuar. Shumë çështje politike në Ballkan që kanë mbetur nga e kaluara historike, mund të vazhdojnë me furi edhe më të madhe. Në të kaluarën e afërt kjo u vërejt hapur në luftën e brendshme të Jugosllavisë.

Stabiliteti politik i përthyer dhe i pagarantuar i politikës ballkanike, është kërcënim shumë më i madh për hapësirat shqiptare. Fatkeqësisht shqiptarët kanë armiq të përbetuar. Ndjenja e përgjegjësisë historike

të Turqisë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në këtë kohë kritike dhe të vështirë bëhet edhe më e rëndësishme dhe kuptimplotë. Shteti i Republikës së Turqisë kontribuon që në Shqipëri të ketë shtet më të fuqishëm, popull të fuqishëm, stabilitet politik dhe në krijimin e mundësive që populli të zhvillohet në mirëqenie, të ketë zhvillim ekonomik dhe që këto përpjekje të jenë në rritje e sipër. Kjo s'është e kufizuar vetëm me shqipërinë, por kjo politikë duhet të përcillet nga të gjithë shqipëtarët që jetojnë në Ballkan. Për këtë politikë rëndësi të veçantë ka afrimi i shqiptarëve mes tyre. Të mos keqkuptohem sepse s'flas vetëm për një shtet. Një të ardhme, ku të gjithë shqipëtarët do të kenë kontakte më të dendura mes tyre, ku mund të fuqizohen marrëdhëniet dhe në këtë kuptim të afrohen si popull, gjithsesi se do ta përkrah edhe Turqia. Ky është njëri ndër elementet që mbështetet në përgjegjësinë shumë të rëndësishme të politikës së Turqisë ndaj Ballkanit. Sikurse e theksova pak më parë, ajo që këtë ditë e bën të rëndësishme është të menduarit tonë për të ardhmen dhe përpjekja për të kontribuar në ngritjen e kësaj të ardhmërie mbi bazament të fuqishëm e të sigurtë, duke i futur në kllapa dhe duke i lënë anash shkëputjet që ishin evidente.

Të gjithëve ua shpreh respektin tim më të thellë.



"ALBANIA IN THE BALKAN POLITICS OF TURKEY: A HISTORICAL EVALUATION"

Prof. Dr. Çinar Özen

Honorable Mrs. Prefect,
Honorable Mr. Ambassador,
Honorable Mr. Edmond IbrahiMay, leader of the Bektashi Order,
Honored guests,

I would like to begin by stating that I feel proud and glad to be here addressing you.

In my university office, I have a very large political map of Albania. As an academic I have always had a special interest toward Albania's political map, but only now I had the good fortune to actually be in Albania. I feel privileged and happy. On the eve of this event, I would like to express a special gratitude to the Alsar Foundation and its head Mr. Mehdi Gurra. I had the opportunity to look at their good deeds here in Albania. I am very enthusiastic of this meeting. I believe that it is really important to organize this kind of academic event, with such a large participation, where we can see how much it is valued in Albania and how the relation Turkey-Albania is considered.

I would also like to thank our ambassador Mr. Murat Ahmet Yörük. The Honorable is one of the dearest friends, whom I know since my student years. Besides, he is one of the well-known experts on the Balkans in the Ministry of Foreign Affairs. Thus, he occupies a very special place within his generation of diplomats. I would like to emphasize that in this situation, his appointment as ambassador to an important center like Tirana is not at all by chance.

Our honored ambassador, beyond no doubt, will play a significant role toward the development of our relations in such a critical time. I thought that it was by chance that the two former speakers addressed the relative

fall-out of our relations. Thus, I believe that those periods, where there was stagnation in between our very good relations, should be put in parenthesis. Essentially the Albanians and the Turks are amicable people and throughout history they have had a similar fate. Unfortunately, this similar fate in the past century did not bring positive results. Moreover, this is the thesis of my speech that the Ottoman Empire as a multi-national empire would have not existed without the Albanians. The Ottomans were a Balkan empire. Its Balkan characteristic was enabled by the Albanians. To put it differently, I am talking about the carrying element of the Albanians, thus a multinational empire, but essentially Balkan. Unfortunately, the Ottomans' last century went through Mayor crises. These internal tumultuous times adversely affected the Ottoman government, especially in the beginning of the 20th century, to make grave mistakes. Both peoples paid very dearly the cost of these mistakes. The Albanians, at the least to the same extent as the Turks, were adversely affected by the fall of the empire. The shared fate, which lasted throughout the empire, almost until its end, placed the political future of these people in difficult processes.

I believe that the Ottoman Empire in the Balkans, much earlier than the time of the creation of the conditions for its downfall, should have created the basis for the building of a great Albania, maybe it even should have created it. At a time when the Balkan Wars seemed inevitable and the European political balance was completely against the Ottoman State, the latter, while troubled and ill-governed, enabled the adverse developments of Albanian politics. Consequently, the conditions of the revolt that began in 1909 and peaked in 1912 surfaced as a result of the unsuccessful politics of both domestic crises and the Ottoman government's foreign politics. The decision of autonomy, which in a way was imposed after the events of 1912, was belated and unexecuted. The nationalism that was building up in the Balkans and the formation of a European political balance in a way that reinforced separatist movements, should have made the Ottoman government follow more closely the policies of the formation of the Albanian political space. In fact, the Albanian space in the Balkans during the Ottoman Empire surpassed the boundaries of today's Albania and as a political space was far larger than the actual one.

Meaning an extensive area, which begins from Durrës and Tirana, elongates towards Pristina and Skopja, stretches down until Manastir

and Janina, and in the North, it reaches Bari, Ulcinj and Niš. Important parts of this area are still inhabited by Albanians. But, at the time, it would have been possible to consolidate the Albanian political entity, which would have been a decision that would dramatically change its politics.

I would like to stress that the Republic of Turkey does not refute the Ottoman Empire's legacy and it has not been disaffected by this legacy. On the other hand, the Republic of Turkey is not an empire but a nation-state. Turkish foreign policy is dictated by the security and interests of the Turkish nation. Turkey is conscious of its responsibility inherited from the Ottomans. This responsibility is examined within its national interest. The feeling of the historical responsibility in the Balkans is a responsibility toward all Albanians. The Republic of Turkey and Albania are two independent nation-states and, in this region, it means a strategic partnership. However, I would like to underline a different phenomenon of the Turkish foreign policy, which bypasses it. Beyond the strategic partnership, Turkey has a historical responsibility toward the Albanians. Turkish foreign policy has always formed bearing in mind this responsibility and even placing it at the center of its Balkan politics. Unfortunately, this responsibility has been maliciously labeled as "Neo Ottomanism" by some circles and in this way, there have been attempts, through a foreign understanding of Turkish foreign policy, to deviate from the essence of its historical basis. In fact, there is no connection between the responsibility that I stressed earlier and this deviating initiative. Some foreign political circles and their experts attempt, as outsiders, to define Turkey's politics toward the Balkans. For some time, they tried to define and formulate the Turkish foreign politics under the worldview of "Neo Ottomanism."

Sadly, we saw, even in Albania, the negative and detrimental effects of this approach. Neo Ottomanism has never been a chief element of Turkish foreign policy. This was a role that other states saw fit for Turkey in the Balkans and tried to impose a political stance. The Balkan strategy, being developed in the form of Neo Ottomanism, never took root in Turkish foreign policy. Even if this exclusionary and transitory state may find voice in some Turkish politicians, it is important to keep in mind that Balkan politics of the Republic of Turkey is essentially constructed by repudiating this approach. Turkey has never aimed to exert its power in the Balkans in either ways, or have a linear worldview defined as

Ottomanism. It has never been the case. The fundamental principle that defines the politics of the Republic of Turkey in the Balkans is the formation in a common way of possibilities for the development of stability, integration, and common well-being, consequently the creation of a common bright future. Therefore, Turkish foreign policy supports the Balkan integration in the European Union (EU) and NATO. Since 1952, Turkey has been a member of NATO, and since 1996, it has a border agreement with the EU. Simultaneously, it continues its priority aim of becoming an EU member.

The EU membership will enable the development of Albanian spaces within an entirety. Unfortunately, some ill-intentioned activities here in Albania and the Balkans that hide behind foreign experts depict the good development strategies with Turkey as being in opposition with EU membership and attempt to portray them as contradictory, which for us is unacceptable. We should not fall prey to this rhetoric, according to which in order to steer toward the EU, we should move away from Turkey.

Albania and the Balkan states advancing toward the EU, will also be getting closer to Turkey. From the beginning, Turkey has been the biggest supporter of Albania's accession to NATO.

Albania's NATO membership had a significant role. We should bear in mind that for all of the Balkans, the close political and economic ties with Turkey are possible even through NATO and EU membership.

On the other hand, I would like to state that because of its own internal political crises, the EU does not place enough importance in the Balkans, especially in Albania. I would also like to add that the EU does not have a concrete strategy for enlargement in the Balkans. The Union is facing very grave internal political and economic issues. In addition, it is clear that it is struggling in overcoming the aforementioned crises. The radical political movements have put European politics under control. The economic crisis further worsens this situation, even in the Balkans. The old centrist European parties are struggling in halting the radical rightist movements. The right radicalism in Europe is being developed by opposing Islam and the EU and as such it has a political platform. Just look at today's France, Italy, Germany, Austria, Belgium or The Netherlands, and see how politically weak the politicians are who support the development of the EU and its Balkan enlargement.

Unfortunately, this situation adversely affects the EU-Turkey relations. I am worried that for those Balkan states it will not be possible to become EU members in the near future. The reason for this assessment is not the developing and strengthening of relations with Turkey. Sadly, it is used to cover a clear truth and showing an attitude toward the developing relations with Turkey. The political developments in the EU do not open the door to the Balkans. On the contrary, the global developments are steering the global economy towards a crisis. The world trade order is being shaken. Europe and the United States of America (USA) are being unable to work in agreement with each other. The USA-China and USA-Russia rivalries are dangerously escalating. While destabilization in global politics is ever-growing, neither the political stability in the Balkans can be seen as guaranteed and continuous. I regretfully and fearfully say that clashes based on historical identity and differences have been inevitable in the Balkans. I would like to repeat that stability in the Balkan politics is not guaranteed. Many political issues that have lingered from the past could continue with greater fury. In the most recent past this was clearly witnessed in the Yugoslavian Wars.

The distorted political stability and unguaranteed Balkan politics is of greater threat to the Albanian spaces. Sadly, the Albanians have sworn enemies. The feeling of Turkey's historical responsibility toward Albania and the Albanians in this critical and hard time becomes even more significant and meaningful. The state of the Republic of Turkey contributes to a stronger Albanian state, a strong people, political stability and enables the people's prospect of improving their well-being, so that there is an ever-growing economic development. This is not confined only within Albania, but this policy should be conveyed to all Albanians living in the Balkans. The approaching of Albanians with each other is especially important to this policy. I do not mean only one state. A future, where all Albanians will have denser contacts, where relations could be fortified, hence getting closer as a people, also backed by Turkey. This is one of the components that relies on the very important political responsibility of Turkey toward the Balkans. As I stressed earlier, what makes today so significant is our thinking of the future and the effort to contribute in the building of this future on a strong and safe basis, by putting into parentheses and forgoing the obvious fall-outs.

I would like to express my deepest respect to all of you!

"TÜRKİYENİN BALKAN POLİTİKASINDA ARNAVUTLUK"

Prof. Dr. Çınar Özen

Sayın Valim,
Sayın Büyükelçim,
Dünya Bektaşilerinin Sayın lideri Baba Mondi Hazretleri,
Çok değerli hazirun.

Bugün burada bulunmak ve sizlere hitap etmekten çok büyük bir onur ve mutluluk duyduğumu ifade ederek sözlerime başlamak istiyorum.

Üniversite'de, odamda büyük bir Arnavutluk haritası var. Akademik olarak hep Arnavut siyasal coğrafyasına büyük bir ilgi duydum, ancak gerçek anlamda Arnavutluk'a ilk defa gelme şansına ulaştım. O bakımdan öncelikle kendimi ayrıcalıklı hissettiğimi ve çok mutlu olduğumu ifade etmek istiyorum. Bu bakımdan özel bir teşekkürü Alsar Vakfı'na ve çok değerli başkanı Sayın Mehdi Gurra'ya sunmak istiyorum. Arnavutluk'ta yaptıkları güzel işleri dün ayrıntılı şekilde gözlemleme şansım oldu. Türkiye-Arnavutluk ilişkilerine çok büyük katkılar yaptıklarını bizzat gördüm. Ayrıca bu toplantıdan da çok etkilendiğimi söylemek isterim. Böyle bir akademik faaliyete, bu kadar geniş ve heyecanlı bir katılım Türkiye-Arnavutluk ilişkilerinin Arnavutluk'ta ne kadar önemsendiğini göstermesi açısından bence çok önemli.

Bir başka teşekkürü Büyükelçimiz Sayın Murat Ahmet Yörük Beyefendiye sunmak istiyorum. Üniversite yıllarımdan tanıdığım bir değerli dostum. Ayrıca Dışişleri Bakanlığı'mızın çok önemli Balkan uzmanlarındandır. Kendi kuşağı içinde önde gelen ve çok değerli bir genç diplomatımız. Şunu ifade etmek istiyorum ki bu kadar kritik bir dönemde Tiran gibi önemli bir merkeze büyükelçi olarak kendisinin atanması kesinlikle bir tesadüf değildir. Sayın Büyükelçim, bu kritik dönemde ilişkilerimizin daha hızlı gelişmesinde şüphesiz çok önemli rol oynayacaktır.

Benden önceki 2 konuşmacı, sanırım o şekilde denk geldi, maalesef daha çok ilişkilerin görece bozulma dönemlerine vurgu yaptılar. Kanımca söz konusu kısa duraklama dönemleri, iyi ilişkilerimizde parantez dönemleridir. Gerçekte Arnavutlar ve Türkler kardeş halklardır ve tarih boyunca aynı kaderi paylaşmışlardır. Bu ortak kader maalesef geçen yüzyılda iki halk için de çok olumlu sonuçlar getirmedi. Benim konuşmamın ana fikri, bu bağlamda, Osmanlı İmparatorluğu'nun çok uluslu bir imparatorluk olarak Arnavutlar olmadan var olamayacağı esası üzerinedir. Osmanlı bir Balkan İmparatorluğudur. Balkan İmparatorluğu olma özelliğini de esas olarak Arnavut halkı sağlamıştır. Bir başka deyişle, Arnavutların taşıyıcı bir unsur olduğu çok uluslu ama esas itibariyle bir Balkan imparatorluğundan bahsediyoruz.

Osmanlı'nın maalesef son yüzyılı çok büyük iç krizlerle geçmiştir. Bu büyük iç karışıklık dönemleri Osmanlı yönetimlerinin özellikle 20. yüzyılın başında çok ciddi hatalar yapmasına neden olmuştur. Bu hataların bedelini iki halk da çok ağır biçimde ödemiştir. İmparatorluğun çöküşünden Arnavutlar da en az Türkler kadar zarar görmüştür. İmparatorluğun içinde neredeyse sonuna kadar devam eden kader birliği, bu iki halkın siyasi geleceğini de zorlu bir sürece sokmuştur.

Kanım odur ki, Osmanlı Devleti Balkanlar'da çöküşün ana hatlarının keskinleştiği dönemlerden çok daha önce Balkanlarda büyük bir Arnavutluk kurulmasının zeminini oluşturmalı, hatta belki de bu devleti kendisi kurmalıydı. Balkan Savaşları'nın ortaya çıkmasının kesinleştiği ve Avrupa siyasi dengesinin tamamen Osmanlı Devleti'nin aleyhine geliştiği bir dönemde, Osmanlı Devleti iç karışıklıklar ve kötü yönetimler altında Arnavut siyasetini olumsuz yönde gelişmelere yol açacak biçimde oluşturmuş ve takip etmiştir. Dolayısıyla, 1909'da başlayan ve 1912'de keskinleşen isyanının ortaya çıkma koşulları, Osmanlı yönetimlerinin dış politika ve iç krizler alanında başarısız olmasının bir sonucu olarak belirginleşmiştir. 1912 gelişmeleri sonrasında ve fiili bir durum olarak kendini empoze eden özerklik kararı çok geç kalınmış ve uygulamaya konulamamış bir karar olarak kalmıştır. Balkanlar'da gelişen milliyetçilik ve Avrupa siyasal dengesinin bu ayrılıkçı hareketleri güçlendirecek şekilde oluşması karşısında Osmanlı yönetimleri çok daha önce bir Arnavutluk siyasal coğrafyası oluşturma politikasını takip etmeliydi.

Aslında Osmanlı döneminde Balkanlarda Arnavut coğrafyası bugünkü Arnavutluk'un sınırlarını aşan ve bunun çok ötesinde bir siyasal

alandır. Bir yanda Draç'tan Tiran'dan başlayan Priştine'ye ve Üsküp'e kadar uzanan, diğer yanda Manastır'a kadar giden ve aşağıda Yanya'ya kadar inen; kuzeyde Bar Ülgün'den, Niş'e kadar uzanan çok büyük bir coğrafyadan bahsediyoruz. Bugün de bu coğrafyanın önemli bir kısmında Arnavut nüfusu kalmıştır. Ancak o dönem şüphesiz bu alanda Arnavut siyasal varlığının konsolide edilmesi mümkündü ki bugünün siyasetini derinden etkileyecek bir karar olurdu.

Burada şunu vurgulamak istiyorum, Türkiye Cumhuriyeti Devleti, Osmanlı İmparatorluğu'nun mirasını reddetmez ve bu mirasa yabancılaşmış değildir. Öte yandan Türkiye Cumhuriyeti imparatorluk değil bir ulus devlettir. Türkiye'nin dış politikasını Türk Ulusu'nun güvenliği ve çıkarları belirler. Türkiye Osmanlı'dan kalan tarihi sorumluluğunun farkındadır. Bu sorumluluğu ulusal çıkarının içinde mütalaa eder. Bu tarihi sorumluluk duygusu Balkanlarda, tüm Arnavutlara karşı da bir sorumluluktur. Türkiye Cumhuriyeti ve Arnavutluk iki bağımsız ulus devlettir ve bu iki devletin bölgede stratejik ortaklığı söz konusudur. Ama ben Türk Dış Politikası'nda bunu aşan daha farklı bir olgunun altını çizmeye çalışıyorum. Türkiyenin stratejik ortaklığın ötesinde Arnavutlara karşı bir tarihi sorumluluğu vardır. Türk Dış Politikası, her zaman bu sorumluluk göz önünde bulundurularak ve bu sorumluluğun Balkan politikasının esasında yer aldığı dikkate alınarak oluşturulmuştur.

Bu sorumluluk maalesef bazı çevreler tarafından kötü niyetli bir biçimde "Yeni Osmanlıcılık" olarak adlandırılan ve tamamen Türk Dış Politikası'na yabancı bir anlayışla, tarihsel dayanaklarından ve esasından saptırılmaya çalışılmıştır. Yukarıda ifade etmeye çalıştığım sorumlulukla, bu saptırma girişimi arasında hiçbir irtibat gerçekte yoktur. Türkiye'nin Balkan politikasını Türkiye dışından belirlemeye çalışan bazı dış politika çevreleri ve uzmanları, Türk Dış Politikası'nı bir dönem "Yeni Osmanlıcılık" anlayışı ve onun kavramlarıyla belirlemeye ve şekillendirmeye çalıştılar. Bu yaklaşımın çok olumsuz ve yıkıcı etkilerini maalesef Arnavutluk'ta da gördük. Yeni Osmanlıcılık, gerçekte hiçbir zaman Türk Dış Politikası'nın ana unsurunu oluşturmamıştır. Bu sadece yabancı devletlerin Balkanlar'da Türkiye'ye bir dönem biçtikleri rol ve empoze etmeye çalıştıkları bir siyasi tavır olarak ortaya çıkmıştır. Yeni Osmanlıcılık biçiminde gelişen Balkan stratejisi, dolayısıyla, Türk Dış Politikası'nda hiçbir zaman kök salamamıştır. Bu dışsal ve geçici durum bazı Türk siyasilerde karşılık bulsa da, gerçekte Türkiye

Cumhuriyeti Devleti'nin Balkan politikasının bu anlayışı reddeden bir esasta geliştiğini akılda tutmak doğru olacaktır.

Türkiye, Balkanlar'da şu veya bu şekilde hakimiyet kurmak veya yanıltıcı biçimde Osmanlı adıyla ifade edilen bir tek tip anlayışı Balkanlar'a empoze etmek peşinde hiçbir zaman olmamıştır. Bundan sonra da olması söz konusu değildir. Türkiye Cumhuriyeti Devleti'nin Balkan politikasını belirleyen ana unsur Balkanlarda barış ve istikrarın, entegrasyonun ve ortak refahın geliştirilmesi, dolayısıyla huzurlu ve müreffeh bir ortak geleceğin inşası için birlikte imkanların oluşturulması çabasıdır. Bu nedenle Türkiye Cumhuriyeti Dış Politikası, Balkanlarda Avrupa Birliği entegrasyon sürecini ve NATO genişlemesini desteklemiştir. Türkiye 1952'den bugüne NATO üyesidir ve Avrupa Birliği'yle 1996'dan beri gümrük birliği içindedir. Avrupa Birliği'ne üye olmak öncelikli hedefini de devam ettirmektedir.

Avrupa Birliği üyeliği Arnavut coğrafyasının bütünlük içinde gelişebilmesi konusunda Arnavutluk'a büyük katkı sağlayabilecektir. Maalesef Arnavutluk ve genelde Balkanlar'da bazı yabancı uzmanlar üzerinden yürüyen ve Türkiye ile iyi ilişkiler geliştirmek stratejisiyle Avrupa Birliği'ne üyeliği birbiriyle çelişen ve hatta zıt stratejik yönelimler olarak göstermeye çalışan, iyi niyetli olarak kabul edemeyeceğimiz faaliyetleri gözlemliyoruz. Balkan devletlerine, Avrupa Birliği'ne yönelmek için Türkiye'den uzaklaşmayı salık veren bu yanıltıcı söylemlerin tuzağına düşmemek gerekir. Avrupa Birliği'ne yakınlaşan Arnavutluk ve Balkan devletleri Türkiye'ye de yakınlaşacaktır. Türkiye en başından itibaren Arnavutluk'un NATO üyeliğinin en büyük savunucusu olmuştur. Arnavutluk'un NATO üyeliğinde önemli rol oynamıştır. Tüm Balkanlar için unutulmamalıdır ki, Türkiye ile yakın siyasi ve ekonomik ilişkiler NATO ve AB üyeliği'nden de geçmektedir.

Öte yandan Avrupa Birliği'nin iç siyasal krizlerle uğraşırken Balkanlar'a ve özellikle Arnavutluk'a yeterince önem vermediğinin de altını çizmek isterim. Avrupa Birliği'nin Balkanlarda gerçek bir yeni genişleme stratejisi olmadığını belirtmek isterim. Avrupa çok ciddi ve derin iç siyasi, ekonomik sorunlar altında zorlanmaktadır. Bu krizleri aşmakta büyük güçlük çektikleri de ortadadır. Radikal siyasi hareketler Avrupa siyasetini teslim almış durumdadır. Ekonomik kriz bu durumu tüm Avrupa'da daha da ağırlaştırıyor. Avrupanın köklü merkez partileri bu radikal sağ hareketleri durdurmakta zorlanıyor. Radikal sağ, Avrupa'da İslam karşıtlığı ve Avrupa Birliği karşıtlığı üzerinden gelişiyor ve siyasal

taban buluyor. Bugün ister Fransa'ya bakın, isterseniz İtalya'ya, ya da Almanya'ya, Avusturya'ya, Belçika'ya, Hollanda'ya; Avrupa Birliği'ni daha ileri götürmeyi esas alan ve Avrupa Birliği'nin Balkan genişlemesini samimi biçimde savunan siyasi liderlerin çok zayıf konumda olduklarını görürsünüz. Maalesef bu durum Türkiye'nin Avrupa Birliği ile ilişkilerini de olumsuz yönde etkilemektedir. Üzülerek belirtiyorum ki genişleme içinde yer alan Balkan devletlerinin görünür gelecekte Avrupa Birliği'ne üye olması pek muhtemel görünmüyor. Bunun nedeni kesinlikle Türkiye ile gelişen ve güçlenen ilişkiler değildir. Bu maalesef yalın gerçeği örtmek için ve bir ölçüde Türkiye ile gelişen ilişkilere karşı bir tavır olarak kullanılıyor. Avrupa'daki siyasi gelişmeler Balkanlar'a böyle bir perspektif sunmuyor. Tam tersi dünya gelişmeleri uluslararası ekonomik sistemi büyük bir krize sürüklemektedir. Dünya ticaret düzeni sarsılıyor. Avrupa ile ABD uyum içinde çalışamıyor. ABD-Çin, ABD-Rusya rekabeti tehlikeli biçimde tırmanıyor.

Dünya politikasında istikrarsızlık unsurları artarken Balkan siyasetinde istikrarın devamı da garanti edilmiş olarak görülemez ve değerlendirilemez. Üzülerek ve korkarak söylemek isterim ki Balkanlarda hiçbir zaman kimliklere ve tarihi farklılıklara dayanan siyasal çatışmalar ortadan kalkmamıştır. Balkan politikası, patlamaya hazır tarihsel volkanlarla doludur. Dünya sistemindeki kriz ve Avrupa Birliği'nin iç çalkantıları Balkanları da şüphesiz etkileyecektir. Tekrar



etmek isterim Balkan siyasetinde istikrar garanti edilmiş değildir. Balkanlarda pek çok siyasal mesele tarihsel olarak kaldığı yerden çok daha büyük şidetle devam edebilir.Yugoslavya iç savaşı bunu yakın zamanda açık biçimde gösterdi.

Balkan politikasında kırılganlık ve garanti edilmemiş siyasal istikrar Arnavut coğrafyası için çok daha büyük bir tehdittir. Arnavutların maalesef kadim düşmanları vardır. Türkiye'nin Arnavutluk'a ve Arnavutlara yönelen tarihi sorumluluk duygusu bu kritik ve zor dönemde çok daha önemli ve anlamlıdır. Türkiye Cumhuriyeti Devleti, Arnavutluk'ta güçlü bir devlet, güçlü bir millet, siyasal istikrar, halkın refah içinde gelişim olanaklarının yaratılması, ekonomik kalkınma için katkı yapmaktadır ve bu çabalarını artırarak devam ettirmek istemektedir. Sadece Arnavutluk'la sınırlı değil, Balkanlar'da tüm Arnavutlar için yoğun temaslarla gelişen bu politikayı takip etmektedir. Arnavutların yakınlaşması bu politika içinde özel önem arz etmektedir. Yanlış anlaşılmasın, tek devletten söz etmiyorum. Tüm Arnavutların yoğun temas içinde olabileceği, ilişkilerini güçlendireceği ve bu anlamda yakınlaşacağı bir geleceğe Türkiye mutlaka katkı yapacaktır. Türkiye'nin Balkan politikasının çok önemli tarihi sorumluluğa dayanan bir unsuru da budur.

Biraz önce söylediğim gibi bugünü önemli ve anlamlı kılan, yüzyılları aşan dayanışma sürecimizde parantez içine alabileceğimiz kopuklukları bir kenara bırakarak, geleceği düşünmek ve birlikte güçlü bir zemin üzerinde bu geleceğin yükselmesine katkı sağlama çabamız olacaktır.

Hepinize en derin saygılarımı sunuyorum.

KONTEKSTI RAJONAL I ALEANCËS STRATEGJIKE SHQIPËRI-TURQI



Shaban Murati
Mjeshtër i Madh në Diplomaci

Nga pikëpamja diplomatike, gjeopolitike dhe gjeostrategjike, aleanca strategjike e Shqipërisë me Turqinë kështillohet nga raportet dypalëshe midis dy shteteve dhe nga roli jetik që këto marrëdhënie luajnë për ekuilibrat strategjikë të Shqipërisë në rajonin tonë. Konsiderata themelore, që duhet mbajtur parasysh, është se aleanca strategjike dypalëshe është marrëdhënie ndërkombëtare. Karakteri dhe interesi i aleancës strategjike nuk lidhet me format e regjimeve politike në një periudhë të caktuar në të dyja vendet, dhe as me emrat e përveçëm, që drejtojnë qeveritë dhe shtetet. Është një konstruksion i politikës së jashtme dhe marrëdhënie e interesit strategjik afatgjatë, pavarësisht kontributit që jep njëri apo tjetri personalitet në periudha të caktuara historike në dobi të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe.

Nuk lidhet me oshilacionet e marrëdhënieve të njërit apo tjetrit shtet me palë të treta. Nuk lidhet me pikëpamje dhe emocione momentale, fetare, krahinore, kulturore, politike, ideologjike etj, të jetës së brendshme, dhe për më tepër, nuk mund të shihet nga këndi i luftës së brendshme politike. Pozicioni, roli, zhvillimi, ekzistenca dhe sigurimi i pavarësisë së shtetit dhe i kombit shqiptar në rajon janë një ndërvartësi kushtesh, faktorësh, rivalitetesh, ku loja strategjike nuk përballohet vetëm dhe

ku rreziqet ekzistenciale të së tashmes për kombin prevalojnë mbi subjektivizmin e keqpërdorimeve të historisë.

Përcaktimi i Turqisë si aleat strategjik i Shqipërisë ka qenë një zgjidhje e drejtë strategjike e politikës së jashtme në vitin 2013, sepse vendosi një ekuilibër të nevojshëm në dobi të pozicionit dhe të rolit të Shqipërisë në rajon.

Lidhur me marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Turqisë periudha postkomuniste ka provuar domosdoshmërinë e përfshirjes së Turqisë në planifikimin strategjik të kapacitetit shqiptar për përballimin e ekuilibrave rajonalë dhe të rreziqeve rajonale ndaj kombit shqiptar.

Janë disa elemente, që i krijojnë Turqisë një profil më të favorshëm, në krahasim me shtetet e tjera të Ballkanit kontinental, në përcaktimin si aleat strategjik i Shqipërisë në politikën e jashtme dhe në veprimin tonë rajonal.

– Turqia është shteti më i madh ballkanik, pjesë e historisë dhe e gjeografisë ballkanike dhe si faktor rajonal ka një rol, të cilin asnjë shtet tjetër ballkanik nuk mund ta zëvendësojë. Turqia është një aleat i nevojshëm dhe i natyrshëm i faktorit shqiptar në rajon në ekuilibrat e forcës, dhe në përballimin e sfidave gjeopolitike të së ardhmes.

– Turqia është një nga anëtarët më të rëndësishëm të NATO-s, është shtet kandidat i BE-së që ka hapur bisedimet e pranimit në BE dhe është shteti më i fuqishëm ballkanik si në planin ekonomik, diplomatik, ashtu dhe në planin ushtarak. Turqia është anëtare themeluese e të gjitha organizatave të rajonit tonë, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërballkanike dhe si e tillë, është një zë i fuqishëm rajonal, solidarizimi i të cilit përbën një nga faktorët më të rëndësishëm diplomatikë të rajonit.

– Kombi shqiptar, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni e kudo nuk mund të harrojnë se Turqia nuk ka asnjë centimetër tokë shqiptare në kufijtë e saj, nuk pretendon dhe nuk do të vijë të pretendojë asnjë centimetër tokë shqiptare. Janë shtete të tjera ato, që kanë dhjetëra mijëra kilometra tokë shqiptare dhe të cilat nuk mjaftohen me atë që na grabitën në 1913-ën, por edhe sot e kësaj dite rivendikojnë prapë territore shqiptare.

– Turqia nuk rivendikon dhe as nuk ka ambicie territoriale ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial tokësor, detar dhe ajror të Shqipërisë.

– Turqia ka njohur dhe ka pranuar zyrtarisht dhe plotësisht kufijtë shtetërorë, tokësorë, detarë dhe ajrorë të Shqipërisë.

– Turqia ka demonstruar mbështetje të jashtëzakonshme për Shqipërinë si shtet dhe për integritetin e saj territorial në periudhën më të vështirë shtetërore të Shqipërisë, në vitin e mbrapshtë 1997, kur shkatërrimi i shtetit dhe i gjithë kufijve tanë nxiti në disa qarqe recidiviste ballkanike mendimin se po ringjallet rasti i akaparimit të ri të territoreve të tjera shqiptare si në 1913.

Konteksti rajonal i aleancës strategjike Shqipëri-Turqi kushtëzohet nga dy rrethana të reja të rëndësishme strategjike dhe gjeopolitike, të cilat nuk i gjen dot në marrëdhëniet e Shqipërisë me shtetet e tjera të rajonit. Janë dy rrethana të reja strategjike, të cilat u përkasin zhvillimeve të shekullit 21 dhe që kristalizojnë natyrshmërinë dhe rëndësinë e aleancës strategjike midis dy shteteve.

1 – Rrethana e parë gjeopolitike dhe strategjike është transformimi i faktorit shqiptar në rajon në faktor ballkanik pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe pavarësimit të Kosovës si shtet. Dalja e dy shteteve shqiptare në skenë i dha faktorit shqiptar në rajon një dimension dhe një peshë, që nuk kishte qenë më parë në raportet gjeopolitike dhe në marrëdhëniet ndërballkanike. Kjo rrethanë u konsideruar e pafavorshme nga shtetet e rajonit, të cilat duhet të llogarisnin tani faktorin e ri rajonal me emrin "dy shtete shqiptare". Krijimi i dy shteteve shqiptare u prit me ftohtësi dhe me armiqësi nga shumica e shteteve ballkanike, sidomos nga ato shtete, që ishin mësuar historikisht të diktonin në Ballkan, ishin mësuar ta nënvleftësonin kombin shqiptar dhe që kishin marrë padrejtësisht shpërblime territoresh shqiptare.

Vetëm Turqia është shteti i rajonit, që përshëndeti dhe mbështeti fuqimisht transformimin e faktorit shqiptar në një faktor ballkanik. Vetëm Turqia e konsideroi zhvillim pozitiv dhe përkrahu fort faktorin e ri rajonal të të dyja shteteve shqiptare. Turqia është e para, që njohu Kosovën si shtet të pavarur dhe që e mbështeti fuqimisht njohjen e saj në arenën ndërkombëtare, duke lobuar energjikisht për Kosovën në OKB, në OSBE, në Këshillin e Europës, në organizatat rajonale e ndërkombëtare, në organizatën e bashkëpunimit islamik, etj. Rëndësia e këtij elementi strategjik në raportet me faktorin shqiptar në rajon dhe në raport me kombin shqiptar, kuptohet më mirë po të mbahet parasysh se shtetet e rajonit si Greqia, Serbia dhe Rumania vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, të mos e njohin Kosovën dhe ky është një qëndrim strategjik jomiqësor i tyre ndaj dy shteteve shqiptare dhe ndaj kombit shqiptar.

2 – Rrethana e dytë strategjike dhe gjeopolitike është fenomeni i ri negativ rajonal i kompozimeve të reja të grupimeve apo të aleancave shtetërore të veçuara në shekullin e 21, me krijimin dhe rikrijimin e grupeve të ngushta aleancash midis dy, tri apo katër shteteve ballkanike. Ky proces, që vjen si reminishencë e fenomenit të grupimeve armiqësore ndaj çështjes shqiptare në periudhën e luftërave ballkanike, bëhet akoma më antihistorik kur kemi parasysh se po ndodh në kohën kur shtetet e Ballkanit janë anëtarë ose aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së dhe të NATO-s. Nëpërmjet samiteve të kryetarëve të shteteve dhe të qeverive shohim të krijohet "grupi Krajovës" me Serbinë, Rumaninë dhe Bullgarinë. Shohim të jetë krijuar grupi i "Traktatit të Bukureshtit" me katër shtete: Serbinë, Greqinë, Rumaninë dhe Bullgarinë. Shohim të jetë krijuar grupi i tri shteteve Bullgari, Rumani, Greqi. Kemi grupin vertikal të tri shteteve Serbi, Maqedoni, Greqi. Mund të përmendim gjithashtu dhe projektin e diplomacisë ruse për të krijuar një aleancë të shteteve ortodokse si Serbia, e ashtuquajtura "Serpska republika", Maqedonia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria. Kjo tendencë duhet konsideruar kundërvënie ndaj procesit të integrimit euroatlantik dhe perëndimor të Ballkanit. Kjo kundërvënie separatiste duhet konsideruar si rrethanë dhe perspektivë jomiqësore ndaj Shqipërisë dhe ndaj kombit shqiptar.

Veçori dhe emërues i përbashkët i gjithë këtyre grupeve e grupimeve të veçuara ballkanike rreth e rrotull nesh, është fakti se të gjitha ato e kanë përjashtuar Shqipërinë dhe nuk e kanë thirrur të bëjë pjesë në asnjë grup, megjithëse Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe disa shtete të këtyre grupeve e grupimeve janë gjithashtu anëtarë të NATO-s. Veçori tjetër e përbashkët, jorastësore, është se të gjitha grupimet e mësipërme janë krijuar vetëm me shtete ortodokse.

Është një zhvillim negativ në rajon, të cilin shteti, diplomacia dhe strategjia shqiptare nuk mund të mos e marrin në konsideratë në kompleksin e faktorëve të sigurisë dhe të perspektivës. Në këto kushte, në mënyrë të natyrshme, Shqipërisë i lind nevoja e një kundërbalancimi strategjik ndaj këtij fenomeni jo pozitiv rajonal. Arsyetimi gjeopolitik dhe rezonanca e interesit strategjik çojnë te logjika e aleancës strategjike me Turqinë, një shtet anëtar i NATO-s. Turqia është shteti ballkanik, që ka mbështetur si asnjë shtet tjetër ballkanik edhe Shqipërinë, edhe Kosovën. Në planin rajonal, një diplomaci largpamëse shqiptare duhet të punojë për ndërtimin dhe për forcimin e një lidhjeje të veçantë Shqipëri-Kosovë-Turqi.

Përpjekjet e shteteve ballkanike për ndryshimin e raporteve të forcës në Ballkan në dëm të faktorit shqiptar dhe intrigat e nëndheshme diplomatike e strategjike ndaj kombit shqiptar, nuk kanë reshtur në Ballkan nga ballkanasit, megjithëse jetojmë në erën e integrimit euroatlantik. Nuk është rastësi që pas daljes së faktorit shqiptar në Ballkan me forcë të re me dy shtete shqiptare dhe transformimit të tij në një faktor ballkanik, disa shtete të rajonit kanë ndërmarrë fushata të vazhdueshme dhe të gjithanshme për ta izoluar faktorin shqiptar dhe sidomos për ta penguar atë që të krijojë raporte strategjike me Turqinë. Këto shtete jomiqësore i tremben zhvillimit të pritshëm, që aleanca strategjike me Turqinë forcon Shqipërinë në rajon. Sidomos pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe pas pavarësimit të Kosovës dhe deri në ditët tona, kur faktori shqiptar është kristalizuar si faktor ballkanik në formën e dy shteteve shqiptare, konstatohet një lëvizje intensive dhe një strategji e qartë e qendrave antishqiptare rajonale për organizimin e një diversioni diplomatik, politik, mediatik, akademik etj., për t'i lënë Shqipërinë dhe shqiptarët pa miq. Dinamika e veprimtarisë së sponsorizuar rajonale dhe jashtërajonale për izolimin apo për vetmizimin diplomatik e strategjik të Shqipërisë, evidenton dy fenomene:

Së pari, ringjalljen e një antiamerikanizmi në jetën politike shqiptare dhe në disa forca politike shqiptare, me qëllimin e çarjes së aleancës së Shqipërisë me SHBA, aleati ynë strategjik global nr.1.

Së dyti, ringjalljen e një vale turkofobie dhe përpjekjeje për të krijuar bllokadë për marrëdhëniet e veçanta midis dy shteteve shqiptare dhe Turqisë.

Shtetet e rajonit, që nuk e kanë dashur dhe nuk e duan realizimin e çështjes kombëtare shqiptare, në strategjinë e tyre diplomatike dhe gjeopolitike rajonale, kanë objektivin që Shqipëria të mbetet e vetmuar në rajon, me qëllim që ato ta kenë më të lehtë për të ushtruar presion dhe për ta mbajtur Shqipërinë si shtet raja.

Duke mos qenë në gjendje të frenojnë tendencën historike të rritjes së faktorit shqiptar në rajon pas pavarësisë së Kosovës dhe krijimit të dy shteteve shqiptare në Ballkan, disa shtete si Serbia, Rusia e ndonjë tjetër, po punojnë në rrugë të tërthortë që ta dobësojnë faktorin shqiptar, për ta privuar atë nga miqtë ndërkombëtarë. Taktika e tyre diabolike është që të përdorin vetë shqiptarët që ta bëjnë këtë detyrë vetëvrasëse për të larguar shtetet mike. Ndaj, del si një çështje me rëndësi të dorës së

parë mbajtja dhe forcimi i lidhjeve me ato shtete dhe faktorë miqësie, të cilat janë më të përputhshëm me strategjinë kombëtare të shqiptarëve në Ballkan. A janë shqiptarët gjithmonë të kujdesshëm në këtë drejtim? Nuk duket se janë tepër të kujdesshëm për të mbajtur miqtë dhe për të qenë luajalë me ta dhe ndodh që disa herë të bien viktima të emocioneve të huazuara, të koniukturave të momentit apo të modës diplomatike.

Një nga kurthet diplomatike dhe mediatike më të përdorua nga shtetet ballkanike, jomiqësorë ndaj çështjes shqiptare, është ajo me ngjyrim fetar. Ka një intrigë diplomatike ballkanike, e cila kërkon që përbërjen dhe raportet fetare t'i paraqesë në frymën e një mode rajonale dhe ndërkombëtare dhe ta devijojë shtetin dhe diplomacinë tonë nga rruga e interesit të vet jetik. Shenja e njëjtë fetare, që Turqia ka me shumicën e popullsisë në Shqipëri dhe me shumicën dërrmuese të popullit shqiptar në Kosovë dhe në Maqedoni, është një kapital diplomatik me vlerë të veçantë pozitive për marrëdhëniet dypalëshe dhe për strategjinë rajonale afatgjatë të Shqipërisë. Ka një praktikë të konfirmuar të diplomacisë botërore dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare për efektin katalizator të shenjave të njëjta fetare në stimulimin e lidhjeve dhe farkëtimin e aleancave shtetërore e strategjike. E shohim këtë edhe në praktikën e diplomacisë së shteteve si Greqia, Serbia, Rumania, Rusia, Vatikani etj. në vendin tonë, në drejtim të pakicave fetare me shenja të njëjta fetare me ta. Në marrëdhëniet ndërkombëtare të një shteti me një shtet tjetër, vendimmarrja themelore i takon shumicës së popullsisë së një shteti, sepse siç vendos shumica në demokraci, ashtu vendos edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shqipëria, Kosova dhe kombi shqiptar i kanë të rralla shtetet e miqësive afatgjata në Ballkan. Fati historik e deshi që interesat tona kombëtare të përputhen me strategjinë e interesave dhe të vlerave, që mbrojnë SHBA dhe Aleanca Atlantike. Këto janë miqësi dhe aleanca, që duhen ruajtur me fanatizëm dhe nuk duhet lejuar asnjë përpjekje, qoftë në nivel shtetëror, qoftë në nivel politik, qoftë në nivel mediatik apo të të quajturës shoqëri civile që ta dëmtojë. Nuk mund të bësh kurrë miq të rij në arenën ndërkombëtare, duke shndërruar në armiq miqtë që ke. Kjo përbën vlerën themelore të miqësisë dhe të aleancës midis Shqipërisë dhe Turqisë në kontekstin rajonal. Aleanca strategjike me Turqinë është një interes jetik i politikës rajonale, i strategjisë rajonale dhe i ekuilibrave rajonalë të Shqipërisë. Turqia është aleati strategjik më optimal i Shqipërisë në Ballkanin kontinental.

REGIONAL CONTEXT OF THE STRATEGIC ALBANIA-TURKEY ALLIANCE

Shaban Murati
Great Master of Diplomacy

From a diplomatic, geopolitical and geostrategic standpoint, the strategic alliance between Albania and Turkey is guided by bilateral relations between the two countries and the vital role of these relations for Albania's strategic balance in our region. The fundamental consideration to be taken into account is that the bilateral strategic alliance is an international relation. The character and interest of the strategic alliance is neither related to political regime types in a certain period in either countries nor proper names who lead governments and countries. It is the body of foreign policy and long-term strategic interest relation despite the contribution of personalities in certain historic period to the benefit of bilateral relations consolidation.

It is neither related to the oscillations of either country with third parties nor momentary, religious, regional, cultural, political, ideological, etc., views and emotions of inner life and it cannot be viewed from the internal political war perspective. The position, role, development, existence and guarantee of the independence of Albanian state and nation in the region comprise an interdependence of conditions, factors, rivalries, where the strategic game is handled alone and current existential risks to the nation prevail on the subjectivism of history misuse.

Definition of Turkey as a strategic ally of Albania has been the proper strategic choice of foreign policy in 2013, because it set the necessary balance to the benefit of Albania's role and position in the region.

As regards Albania-Turkey relations, the post-communist period has proved the necessity to involve Turkey in the strategic planning of Albania's capacity to cope with regional balance and risks.

Turkey's favorable profile as a strategic ally of Albania in foreign policy and regional actions is enabled by several elements, as compared to other continental Balkan countries.

– Turkey is the greatest Balkan country and it is part of Balkan history and geography, and from the regional perspective it plays a role that cannot be substituted by any other Balkan country. Turkey is an indispensable and natural ally of the Albanian factor in the region with respect to power balance and facing geopolitical challenges of the future.

– Turkey is one of the most important NATO members, candidate state to the EU and has started EU accession negotiations and it is also the most powerful Balkan country in terms of diplomacy, economy and military. Turkey is the founding member of all organizations in our region that deal with inter-Balkan relations and as such it serves as a strong regional voice, whose solidarity comprises one of the most important diplomatic factors in the region.

– The Albanian people in Albania, Kosovo, Macedonia and elsewhere cannot disregard that no land in Turkey was once and will ever be Albanian. Other countries are the ones that have thousands of miles of Albanian land in their territories and do not feel limited to what they robbed from us in 1913, but to this day they claim Albanian territories.

– Turkey does not claim and does not plan on claiming the terrestrial, maritime and air territory and sovereignty of Albania.

– Turkey has officially and completely recognized and accepted air, maritime, terrestrial and national borders of Albania.

– Turkey has demonstrated an extraordinary support for Albania as a country and its territorial integrity during one of the most difficult periods of time – 1997 – when the destruction of our country and borders fostered the belief of some Balkan groups that a new opportunity to seize Albanian territories is rising once again as in 1913.

